

ALBANIAN POST

**Nr.
18**

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - Telephone: 07984497444 - contact@fjalaelire.com - www.fjalaelire.com



15 Aqif Neli...



23 Egzona Makolli...



09 A na duhet...

**SHKURT /
FEBRUARY
2020**

Nga Agim Aliçkaj

GËZUAR PAVARËSIA E KOSOVËS POPULLI SHQIPTAR

Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 Shkurt të vitit 2008, padyshim, ishte ditë e madhe për Kosovën dhe mbarë kombin shqiptar. Edhe pse me mungesa të mëdha, ishte e vetmja mënyrë që Kosova, të bëhet e pavarur, dhe të njihet qysh në fillim nga vendet më të fuqishme të botës dhe vendet demokratike perendimore, përfshirë SHBA, dhe të tjera. Kjo, u përforcua edhe me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Pa hyrë në një analizë të tij, plani i Ahtisarit përbën në vete koncesionet më të mëdha të mundshme të popullit shqiptar të Kosovës për t'a arritur pavarësinë. Pas 11 vitesh të kësaj pavarësie, ngjarjet e...

(vijon ne faqen 02)



24/7 orë linjë emergjence
07878335000



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



**Këshilla
ligjore
FALAS**

**Specialist i azilit të
trafikimit njerëzor**

RASHID & RASHID LAW FIRM
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666

(vjon nga faqja 01) ... fundit, fatëkeqësisht na bëjnë më shumë të brengosemi se sa të gëzohemi. Edhe, sa koncesione tjera në dëm të interesave të veta duhet t'i pranojë populli i Kosovës? Me punën këmbëngulese të armikut tonë dhe plotësisht me fajin tonë, Kosova rrezikon të shuhet si shtet.

Bisedimet me Serbinë dhe sanksionet e qeverisë së Republikës së Kosovës

Shtrohet pyetja se çka fitoi Kosova nga bisedimet me Serbinë prej shpalljes së pavarësisë deri më sot?! Përveç disa çështjeve të vogla që ishin me shumë në interes të serbëve, Kosova, fitoi fusnota dhe zvogëlim të

metutjeshëm të sovranitetit. Tashti kemi ardhë në pikën më kritike të humbjes përfundimtare. Pse duhet të bisedohet me Serbinë kur ende nuk ka kërkuar falje për krimet dhe gjenocidin ndaj popullit shqiptar të Kosovës, kur ende nuk ju kethen të pagjeturit familjeve shqiptarë në vuajtje të tmerrshme dhe të pafund, kur ende nuk pranon reparacionet për dëmet e shkaktuara. Nëse jemi shtet, pse duhet të bisedohet me Serbinë për çështje të mbrendshme të Kosovës?! A e kemi të qartë se për serbët e Kosovës duhet biseduar me përfaqësuesit e serbeve të Kosovës e jo me Serbinë. Pse nuk ngritet çështja e të drejtave të popullit shqiptar të Kosovës

lindore në nivel të drejtave të minoritetit serb të Kosovës.

Cili shtet demokratik mund t'a mohojë këtë të drejtë?

Sanksionet e fundit ekonomike të Kosovës kundër Serbisë na dhanë krenari dhe shpresë se, më në fund, edhe Kosova e mori veten dhe se edhe ajo "ka një grusht të fortë". Kjo, ka edhe një element tjetër shumë pozitiv, edhe pse me mundime, ekonomia e Kosovës orientohet nga Shqipëria dhe vendet tjera mike. Pse tashti duhet t'i nënshtrohem presionit ndërkombëtar dhe fatëkeqësisht edhe atij të mbrendshëm për tërheqjen e tyre?! Serbia e thotë haptas: "në pranojmë

të hyjmë në bisedime vetëm nëse shqiptarët bëhen të arësyeshem dhe heqin sanksionet, por në kurrë nuk do t'a njohim pavarësinë e Kosovës". Pas kësaj deklarate, çfarë kuptimi ka heqja e sanksioneve?! Çfare kuptimi kanë bisedimet me Serbinë kur ajo po të tregon që më parë se nuk do të njeh si shtet kurrën e kurrës. Për ma keq, është e qartë se Serbia, përfaqësuesit e Kosovës dhe shqiptarët nuk i njeh as për njerëz e lërë më për bashkëbisedues të barabartë. Sanksionet nuk duhet të hiqen derisa Serbia, nuk i plotëson kushtet e lartëpërmendura dhe nuk e njeh pavarësinë e Kosovës.

JETONI TRANSPORT MALLRASH ANGLI - SHQIPERI - ANGLI



Ne transportojmë valixhet tuaja të bagazheve dhe çantat e dorës duke ua dorëzuar të afërmve tuaj me përgjegjësi të plotë.

info@jetonitransport.co.uk

+44 7 737 597 000

+44 7 507 444 654

jetonitransport.co.uk

+355 68 22 0 5555



185 Station Road, Edgware, HA8 7JX

0209306873

MIRËSEVINI

CRYSTAL CAFE

MUZIKË LIVE E PREMTE DHE SHTUNË



Ne Ofrojmë:

Ushqime tradicionale, Evenimente festive, ditëlindje, mbrëmje, dasma etj. (50-60 vetë)
Pije të ndryshme shqiptare:
Verë të kuqe dhe të bardhë
Raki Rushi Skrapari

EMOCION I HELMUAR

Dashuria dhe urrejtja mbetën të verbra. Të verbra po aq sa zilia. Po aq sa indoktrina e saj xhelozia. Po aq sa gjendja e përbindshme ... e përbindëshit Antinjeri. Sakaq, zilia, ose më saktë xhelozia, mund të helmonin mendjen më të pastër dhe të prodhonin kudo një përbindësh. Një përbindësh me sy të gjelbër, që tërhiqej nga brenda të çarës së kuqe në tërë mizorinë e vetë. Kjo mizori e shkëputur nga thellësitë e lashtësisë, rishfaqej me forcën më të madhe e më të fuqishme të vetë mitit nga ku lindi Oizis, ajo perëndeshë e mjerimit, ankthit, hidhërimit dhe depresionit. Si vajza e Niksit, perëndeshës së natës dhe binjake e perëndisë Momos, emri i saj latin Miseria, u duk thellësisht brenda kornizave të kohës, nga e cila ndoshta rrodhi dhe fjala 'mjerim' në fjalorët anglezë. Mjerim. Mjerim akoma më i thellë. Ai u zvarrit gungënor, duke shkatërruar edhe atë pak të ëmbël që kishte mbetur në gjirin e popullit të shumëvuajtur, duke përlurur gjithëkënd që donte lirinë dhe madje edhe llojin e sojin e vetë kur ndodhte të thuhej, sikurse Havzi Nela e

kishte parathënë në poezinë e tij "Nuse më dhanë robninë". Dhe nuse robninë e jetës, ta jepte krejt ajo strukturë mizerie, me sulme të errëta, me sulme nate. Këto sulme keqdashëse në errësirën e natës, duke marrë përsipër të të marrin shpirtin ngadalë duke pritur që të ulesh në gjunjë, të dobësohesh dhe të heqësh dorë nga "liria", e drejta jote e të bëhesh i aftë për të mos luftuar. Një emocion përbindësisht i helmuar. I helmuar nga mizeria. Tek mizoria ishte vetë paqëndrueshmëria, tek insistimi mbetej vetëm dëshpërimi. Paqëndrueshmëria dhe dëshpërimi ishin djegia, pasiguria dhe shqetësimi i dritës së saj natyrisht ashtu sikurse e qas në poezinë e tij Havzi Nela ishin vetëm vdekja: "Jo or jo, njizet vjet burg nuk u mjaftuen S'u ngopën ushunjat, xhelatët mendjemarrë; Më ndoqën kamba-kambës, lakun ma shtrënguen Më ndoqën gjithë jetën, pse jo deri në varr!"

Vdekja që sillej rrotull nga ky përbindësh i struktur tek mizoria. Ky përbindësh me sy



të gjelbër hera-herës ishte i padukshëm. Si do të luftohej me diçka që as nuk mund ta shihje, as që mund ta dëgjoje, ose as që mund ta nuhasje, por vetëm të ndjeheshe, i pafuqishëm brenda vetë asaj kaskade të ngritur me themele tek mizoria. E vetmja pastërti ishte teke pena, tek mendja, tek stili dhe talenti... Ajo pastërti ishte thelbi i miqësisë. Pastërtia e miqësisë tek poeti dhe vargu i tij tejkalonte edhe të keqen, si zili, që vinte nga ajo mizori. Dhe poeti e dinte: "Ma hoqën përgjithmonë, të shtrenjtën, lirinë, M'i hoqën të gjitha, kot kam mbetë i gjallë Shtëpinë ma rrënuen, nuse m'dhanë robninë M'lanë pa vajzë pa djalë, m'lanë të qaj me mall."

E lanë në prishjen e jetës, ndaj ai e dinte se e nuhaste urrejtjen e tyre: "Thue se u zuna fronin,

u prisha humorin, Më vrej në me inat e fort mirë më njohin, Nuk më thyen kurrë, jetën krejt ma nxinë." Dhe kjo ndoshta ishte evetmja këshillë për veten, për të gjithë, për tërë jetën, për të vërtetën. Pra, dukej sikur poeti udhëzonte: para se të çojë në prishjen tuaj, gjeni ndonjë ndihmë, edhe nëse është e vështirë, edhe nëse këto ndjenja të tmerrshme po ju rëndojnë shumë. Por për ata që nuk kanë askënd, dhe ata që janë të vetmuar, është një zgjidhje e thjeshtë, edhe më e vështirë për tu duruar... Prisni gjithçka që ju bëri të ndjeni këtë mallkim. Bëni më shumë sa duhet për të shfarosur këtë dreq, para se të bëhet edhe më keq.

Përballeni bindshëm mëngjesin që vjen.



ATDHEU YNË: I PAQES DHE UNITETIT

Ata erdhën. Erdhën sikurse ndodh të vijnë të tillët. Të bekuar me kasandra. Të veshur me skafandra. Erdhën, por ata bënë pluhur vaktin tonë të preferuar, diellnxënien e jetës sonë. Erdhën me trupa metalikë dhe shkërmoqën ajrin tonë. E shkërmoqën të vetmin që kishim ende shpresë se do të kishte lirinë dhe bekimin e tij për ne. Dhe ne... Ne si përherë. Të pashpresë, si zogu në gojën e një gjarpëri. Të pashpresë dhe kur u këndojmë këngë zotërinjve tanë të ardhur nga e njëjta strofkë, të ripërtypur në të njëjtën gojë, ku i kishin bllokuar të gjitha fjalët që dikur ishin Hosana dhe Urra: "Rroftë De(mo)kracia!" Ndërsa zemra jonë rreh dhe del në gjoks si ndonjë sfungjer i fryrë nga lagështia e jargave dhe pështymave që prodhon urrejtja. Ditë pas dite e njëjta gjë. E njëjta pritje. E njëjta sakëlldi.

Ndërsa në trurin tonë nga mëngjesi deri në darkë rritet mendimi si kallami i peshkatarit që pret e pret gjahun e tij në një pellg, gjahun me të cilin të ushqejë fëmijët e tij, që ende presin të bëhen gjashtëmbëdhjetë dhe të bëjnë gati torbat e njëjta me qindra bashkëmoshatarë nga Jugu në Veri, në udhëtimin për s'di se ku. E ky është i vetmi kallam, kallami i Zotit, e quajmë në heshtjen tonë të shpërfillur. Ne pyesim veten pse kallami i Zotit tonë duhej të dashurohej edhe me këtë pikëtakim, me torbën në krah, a nuk i kishte mjaftuar kontrata gjysëmshekullore me kurrizin tonë? Sa i ftohtë mund të jesh? Eh, sa i ftohtë... Pse e urren trupin tonë të lodhur kur e din që ka një zemër të qetë, të urtë, të dashur, të bërë palë me retë. Një zemër që tretet e shtrydhet..., e prapë një zemër e artë, një zemër që mbetet.

Mbetet?

E detyruar të durojë, të pranojë pranë dy deteve, pranë dhjetëra lumenjve, pranë dhjetëra liqeneve të shuajë etjen, të rrëkëllejë racinin e ujit, dhe e ndjen se dikushi, ai zbritësi dhe hypësi i mishtë në trupin metalik ende kërkon të na bekojë me durimin për Demokraci dhe të na shikojë të lirë në bekimin e tillë se jemi të gatshëm të vdesim edhe nga etja... për të qenë në një Europë ku kemi lindur, si të tillë europianë. Ishin fjalët e fundit të një brezi që ndau llogoret e etjes, mbijetesës, ikjes dhe ardhjes së lotit, zbardhjes dhe errësimit të motit, ishin fjalët e fundit të plakës, para se ti'a merrte jetën memorja e lodhur nga tërë zhgarravinat me sy të fryrë nga të qarat e fëmijëve në ëndërrat e saj. Lotët në sytë e foshnjave. Ndërsa vëzhgojnë vëllezërit dhe motrat e tyre nën moshë që shiten me çmim

të ri për vetëm një qëllim, zbrazjen e Dheut amë. Atje loti struket. Struket dhe shkruhet si Lavdi, Prosperitet, Demokraci. Dhe kjo ndodh si në zyra, si në skuta të tilla të buta, si në një mjedis jetim... Të hekurtat udhë ende s'kanë ndonjë rrëfim. Atdheu ynë i paqes dhe unitetit ka mbetur në një kohë dhe në një tokë pa kthim. Ata ikin. Ikin sikurse ndodh të ikin të tillët. Të dëbuar me kasandra. Të maltrajtuar me skafandra. Ikën, por ata bënë pluhur vaktin e tyre të preferuar, diellllënien e jetës së tyre. Ikën me trupa metalikë dhe shkërmoqën ajrin e gjerë. E shkërmoqën të vetmin që kishim ende shpresë se do të kishte lirinë dhe bekimin e tij për ne. Dhe ne... Ne si përherë. Banketojmë, ngrejme dolli dhe krenohemi në teori për hir të dovetit: Rroftë Atdheu ynë i paqes dhe unitetit!





RASHID & RASHID

Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



Këshilla ligjore FALAS

Specialist i azilit të
trafikimit njerëzor

- Dokumente udhëtimi
- Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- Kur jeni kotigjent për t'u riatdhesuar ose të ndaluar nga organet e emigracionit
- Mbulojmë të gjitha aspektet e emigracionit
- Zgjatje vizash
- Leje pune
- Rishikim juridik
- Apelimi Tribunali
- Rastet e trashëgimisë

24/7 orë linjë emergjence
07878335000

Rashid & Rashid Solicitors, si të gjithë avokatët e tjerë në praktikë në Angli dhe Uells, është Kompani e autorizuar dhe e rregulluar nga Autoriteti i Rregullimit të Aplikantëve.

Avokatët tanë të emigracionit kanë mbi dhjetë vjet përvojë në fushën e emigracionit dhe ligjit të azilit.

RASHID & RASHID LAW FIRM
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666

PSE ADOLESHENTËT DUHET TË MËSOJNË DHE TË FITOJNË

“Never Ever” (“Asnjëherë kurrë”), një raport i shkurtër që shqyrton një rritje të numrit të njerëzve në Mbretërinë e Bashkuar që nuk kanë punuar kurrë, bëri tituj këtë muaj. Botuar nga Fondacioni “Rezolutë”, ai nxori në pah numrin në rënie të të rriturve të rinj me punë si të ashtuquajturën vetëm të shtunën. Botimi tregoi se shkalla e punësimit të fëmijëve nga 16 deri në 17 vjeç është pothuajse përgjysmuar gjatë dy dekadave të fundit - nga 48.1 përqind në 1997-99 në 25.4 përqind në 2017-19. Në të vërtetë, ne nuk kemi nevojë për një raport për të na thënë se punësimi i adoleshentëve është zhdukur. Adoleshentët kanë qenë të

dukshëm duke punuar në vende të ndryshme, dyqane qoshe, kafene, restorante, parukeri dhe supermarkete. Tani ata nuk janë askund për t'u parë. Pra, si ndodhi kjo? Do të ishte shumë e thjeshtë për të fajësuar punën e ndrojtur të Gjeneratës së ashtuquajtur “Kristale Dëbore”, shumë e zënë në mediat sociale, apo lojrat për tu shqetësuar me rafte të grumbulluara deng në një supermarket. Por kjo është e padrejtë. Ssoqëria është shoqëria e dominuar nga të rritur, është kjo shoqëri që ka ndryshuar, jo të rinjtë. Ka vite që unë u them studentëve që ata tani mund të marrin një punë dhe të fitojnë paratë e tyre. Unë konstatoj se askush nuk ka përmendur më parë

punësim për ta. As prindërit e tyre as ... shteti që i ka veshët të shurdhër dhe i lë të ikin, as të tjerët nëse i kanë ata, motrat e vëllezërit tyre, më të vjetërit, të cilët gjithashtu nuk punojnë. Shumë prej tyre supozojnë se duhet të jesh 18 vjeç për të qenë në gjendje të punosh. Në të kaluarën shihej si krejtësisht e natyrshme që adoleshentët të punojnë. Megjithatë, shumë të rritur, veçanërisht ata në zyrtarizëm, mendojnë se ideja është e ngjashme me “skllavërinë moderne”. Ata supozojnë se kushdo që punëson një adoleshent duhet të ketë një motiv të fshehtë, mjaft urgjent e tejet të domosdoshëm, të fshehtë. Për më tepër, shumë prindër të klasës së mesme

më tej me rënien e punësimit të adoleshentëve duke i nxitur fëmijët e tyre të përqëndrohen vetëm në anën akademike të jetës, kanë krijuar një mendim ndryshe, se vetëm shkolla është dhe mbetet zgjidhja. Presioni për të hyrë në një shkollë kualifikimi, apo kurs pune dhe më pas në një universitet të lartë do të thotë që shumë adoleshentë kalojnë kohë që mund të harxhohen duke fituar pak para, duke u detyruar të mësojnë me zor nga mësues privatë dhe gjëra që nuk i pëlqejnë vetë, por prindërit e tyre, ose duke u përfshirë në oraret e rishikimit të së ardhmes.

DJATHI I SHARRIT TEK HILAL KIRBURN HIGH ROAD

Djathi i Sharrit gjendet me një cilësi dhe paketim, çmime dhe shije konkurruese tek Hilal Kirburn High Road. Me një konkurrencë të paparë ai tashmë ndodhet në të gjitha tryezat shqiptare. Pronari, miku i shqiptarëve Mahmudi e garanton atë. Djathë i Sharrit (Anglisht: Sharr cheese, maqedonisht: Šarski sir/Шарски сир) është djathi i fortë i cili prodhohet në rajonin e Maleve të Sharrit, në vendet përreth qytetës së Sharrit, Gorës, Opojes dhe Shtërpçës, në Kosovë. Djathi i Sharrit prodhohet nga përpunimi i qumështi të deles dhe lopës dhe zakonisht i shtohet sallatave si dhe është e shoqëruese e domosdoshme e, piteve, shërbehet edhe me bukë ose mund të hahet edhe i vetëm. Prodhohet dhe gjendet në treg në çdo kohë të ditës ose të vitit.

Tradita e prodhimit të Djathit të Sharrit ka kaluar nga brezi në brez për shekuj me radhë. Nga vitet 1890, ky lloj djathi u bë shumë popullor. Më 28 korrik 1901 gazeta serbe Carigradski glasnik njoftonte se Djathi i Sharrit kishte tronditur tregjet fqinje për shkak të pamjes së saj të verdhë yndyrore dhe shijes së tillë cfare nuk ishte vërejtur edhe në djathërat e llojeve tjera. Ekzistojnë dy variante kryesore të Djathit të Sharrit: Djathi tradicional (i fortë) dhe Djathi i Butë. Dallimi kryesor në mes të dy është vet gjendja e tij, edhe pse kripa dhe aroma mund të ndryshojnë. Varianti i butë është paraqitur më vonë ndërsa tipi tradicional është prodhuar në mënyrë të njëjtë që nga fillimi dhe është gjithashtu i preferuar shija e të dy varianteve. Konsumi i Djathit të Sharrit



është dominues në qytete të tilla si Prizreni, Ferizaji, dhe Prishtina, edhe pse ai konsumohet edhe në rajone të tjera. Të dhëna tregojnë që Djathi tradicional i Sharrit, varianti i fortë konsumohet më shumë se sa varianti tjetër i tij, Djathi i butë i Sharrit për shkak të preferencave të konsumatorëve. Marka më

e njohur e cila merret me prodhimin e Djathit të Sharrit në Kosovë është firma “Sharri”. Sasitë e konsumimit të Djathit të Sharrit për një muaj sillen nga 2-3 deri në 10 kg. Djathi i Sharrit është gjithashtu i popullarizuar në mesin e restoranteve me rreth 43,000 kg të konsumuara në vit.

BASHKËBISEDIM LETRAR ME POETIN PETRIT RUKA

(Vijon nga numri para-ardhës)
...F. Terziu: Dhe ndodh që ta shohim nënën ashtu në ekranin tonë të qelqtë të memorjes, jo pak herë bardhë e zi. Në këtë ekran na mungon, por të paktën e kemi një fotografi. Dhe atë e prodhon dashuria e pavdekshme, jo shteti që e mban atë si robinë. Pikërisht ashtu sikurse ju e thoni "Nëna foto nuk ka veç asaj të pasaportës/që gjendet dhe në varrin e saj, ku u fal./Shteti veç njëherë e dërgoi fotografën /për robërit e tij/deri lart në mal..."

P. Ruka: Po, pas ikjes së saj përpqesha të rendisja kujtimet për të. Se këtë punë bën malli për të ikurit, natë e ditë sistemon arkivat në mendje. Dhe shpesh pyesja, po fotot, fotot e saj ku janë. Një ditë zbulova një pasaportë të vjetër të saj dhe pashë atë foton e vockët bardhë e zi të pasaportave tipike të socializmit... Dhe edhe pse e dija, ndonjëherë të duket sikur përplas kokën pas një muri kur një send a pyetje të zbulon një botë të tërë të fshehur atë harruar në mendje. E titullova fare thjeshtë "Nëna foto nuk ka" Dhe shpresoj t'i a kem dalë mbanë për të thënë se ato janë vetë sakrifica, nënat nuk kanë nge për foto, nuk kanë nge as për të vdekur kur lindin fëmijë. Ishin kohë aq të varfra, sa njeriut i mermin dhe mundësinë e fundit, kujtesën, kujtesën që mund të fiksohet në ca foto. E di mirë si mësues i fshatrave malore pesëdhjetë e ca vite më parë se mijëra e mijëra njerëz lindnin e iknin nga kjo botë veç me foton e pasaportës. Një dhembje e madhe. Fotografit kalonin njëherë në dhjetë vjet a më shumë, kur bëheshin regjistrimet e reja të popullsisë dhe letërnjoftimet e tyre. Nëna ime si grua fshati pati të njëjtin fat. Ato, (ata) iknin nga kjo botë pa lënë pas as fytyrën e tyre në letër. Fotot e tyre ishin shkrepur ujërat e iknin poshtë drejt detit duke u nisur nga krojet dhe përrrenjtë e fshatrave... Besoj se këto thotë poezia ime. me pendimin tim në fund, se përse unë kur u bëra kineast, nuk i

bëra ca foto. Të kem harruar? Jo, është thjesht destini i saj, Duhet të ikte si mijëra të tjerë, pa tradhëtuar një rit të lastë fatkeq të këtyre viseve e të fatit të trishtë shqiptar...

F. Terziu: Ato që më së shumti shfaqen përtej imazheve në qasjen e tyre memoriale, janë të padukshmet e lidhjes me nënën. A ka të tilla ndjesia poetike e Rukës?

P. Ruka: Duhet të jenë së paku pesë gjashtë poezi që kam shkruar në jetë për nënën. Dhe e di që nuk e kam rrokur dot shpirtin e saj të madh në këngë. Ishte një grua e jashtëzakonshme, e butë, shpirtbukur dhe shpesh në fëmijëri na mblidhte të këndonim rreth oxhakut. Kurrë se kam kuptuar dot pse e bënte këtë në tërë atë varfëri. Në poezinë time nëna është shfaqur shpesh, ndonjëherë dhe atje ku as vetë nuk e kam besuar se mund të ketë vend. Me sa duket lidhjet me të, (ato të padukshmet për të cilat po më pyet,) e sundojnë mendjen time fund e krye. Sado e çuditshme të duket ajo mbizotëron në artin e çdo poeti, sepse nëna veç të tjerash është dhe estetika totale e një krijuesi. Po, po tërë estetika e tij krijuese, sepse prej saj të ka rdhur gjithçka, gjuha, gjendjet emocionale, shijet. Nëna është akademia e parë estetike e krijuesit, poezia dhe romani i parë i yti.

F. Terziu: Nëse do të rilexonim poezitë e shkruara ku është raporti i nënës me tërësinë e vetëekzistencës në jetën e poetit?

P. Ruka: Raporti është totalisht sundues. Mbase duket e vështirë për t'u shpjeguar, por në nënvetëdhinë, një bir, pa e ditur as vetë; është tërë jetën para nënës si para një gjykatësi, jurie, provimi. Madje edhe kur shkruan. Më kujtohet se sa herë doja së largu a së afërti ndonjë vajzë në rininë e hershme pyesja veten: a do ta pëlqente nëna

ime këtë vajzën që dua unë po ta shihte. Nuk e di pse ndodh kjo, nuk ka shpjegim. Mbase thellë në vetvete në nënndërgjegjen tënde vlen edhe për krijimtarinë. Mund të dëgjohet si një marrëzi. Por unë e besoj se kjo ndodh. Dhe ja përse ngul këmbë që nëna është sundimtaria e plotë e tërë jetës së një njeriu. Me sa duket, një lloj "matriarkati" shpirtëror vijon akoma në jetën e njeriut pa e ditur as ai vetë.

F. Terziu: Shpeshherë jeta është një rreth ku hyjnë e dalin lindja, jeta dhe vdekja. Aty natyrisht është vendlindja, Tepelena...

P. Ruka: Ah, Tepelena. E di që do të ngaj një i marrë, por unë do të vdes me bindjen se është një nga viset më të begata dhe fatdhënëse të Shqipërisë. E di sapo e them këtë mendoj pyetjet e zemëruara të të tjerëve. Po çka Tepelena për tu mburrur? Ashtu, plot gremina, shkëmbinj e vogël dhe e varfër. Po, por duhet të lindësh e të jetosh aty të kuptosh se ka peizazhe fantastike. Nuk di sa e dinë, po ku gjendet një vis kaq i vogël të ketë në atë një pëllëmb vend pesë lumenj që i përdridhet si gërsheta vashe njeri - tjetrit?

Ujërat janë vetë bukuria tronditëse e një vendbanimi. Dhe pastaj folklori, kënga labe. Në Tepelenë kapen mushkритë e Labërisë, Tepelena është Big Bang- i folkorit shqiptar. Ngaj i tepëruar? Po mirë, hapni përmbledhjet folklorike dhe binduni se aty kanë lindur më shumë se gjysmat e kryeveprave folklorike, nga "Mbeçë more shokë mbeçë" e deri tek "Ndrinte si bora në hënë." Për të mos u futur tek këngët historike se aty mbytesh e ngre duart përpjetë... Ja pse e quaj veten me fat. Vetëm nëpër dasmat e fëmijërisë, një fëmijë tepelenas bën aq shkollë letërsie, dëgjon aq shumë poezi, sa as në shkollat më të mira nuk do ta kishte këtë fat. Ndaj edhe Tepelena në

poezinë time hyn e del pa asnjë lloj "dogane". Nuk kam ç'i bëj, më urdheron si t'i teket.

F. Terziu: Ku mund të ndalet forca poetike tek e vërteta e gjithëgjendshme e Rukës..., nëse ndodh të jetë një e vërtetë tek vetë kjo lidhje.

P. Ruka: Poezia është tashmë i vetmi gëzim i madh i jetës sime. Nuk e kuptoj dot tani se si do të ishte jeta ime pa të, nuk e di... E dua këtë vuajtje të pafund, që është një lloj egzistence shpirtërore. Dhe sa më shumë përpqem t'i afrohem kësaj të vërtetës së gjithëgjendshme, për të cilën më pyet, aq më shumë e ndjej se jam i pakënaqur me veten. Do të desha të kisha shkruar më shumë e më mirë. Dyshimi është një nga tharmet jetike të të shkruarit, pa të cilin nuk ka krijim, nuk ka poezi. Nuk de di në se ka një të të vërtetë tek lidhja me poezinë, por kërkimi i saj është një vërtetëe madhe më vete. Ashtu siç ndodh me lirinë për të cilën miku im i dashur Pëllumb Kulla shkruan diku se: "Pritja e lirisë është më e bukur se vetë liria." Edhe me procesin e krijimit kjo ndodh. Thjesht je në kërkimin e pafund të kësaj të vërtete që i jep një kuptim të hatashëm tërë jetës tënde.

F. Terziu: Ku ka një lidhje të tillë ka edhe një mesazh për të gjithë, ndoshta dhe edhe për Fjalën e Lirë...

P. Ruka: Fatmir i dashur, tani po deshe, mbylli veshët se do të lëdvoj. Po ti mos u skuq. Unë pothuajse të kam ndjekur rregullisht. Ti ke bërë aq punë për promovimin e letërsisë shqipe, me "Fjalën e Lirë" sa këtë nuk do ta bënte dot një Institut i tërë. Kam lexuar qindra shkrime të tuat për letërsinë, krijuesit dhe botimet e raja shqiptare. Më gëzon shumë kjo gjë, shumë. Aq më tepër në këtë shkurnajë shkrimesh të kota gjithandëj ku futen me një guxim të marrë edhe amatorë që japin gjykime për të vënë duart në kokë...

SKELA “JET SCAFFOLDING” CILËSI, PROFESIONALIZËM, GARANCI

Skela “Jet Scaffolding” tregon gjithnjë e më shumë përkujdesje në të tre elementët e saj të suksesit. Themelet e mira janë thelbësore. Shpesh kornizat e skelave kërkojnë më shumë pllaka bazë të thjeshta për të kryer dhe përhapur në mënyrë të sigurt ngarkesën. Skela “Jet Scaffolding” përdor pllaka bazë në sipërfaqe të betonit. Për sipërfaqet si trotualet ose pllakat bazë të asfaltit janë të nevojshme. Për sipërfaqet më të buta ose më të dyshimta përdor tabela të vetme, nën një standard të vetëm, një tabelë e vetme duhet të jetë së paku 1.000 centimetra katrorë (160 in²) pa një dimension më të vogël se 220 milimetra, trashësia duhet të jetë së paku 35 milimetra (1.4 in). Për skelat e ngarkesës më të rënda mund të kërkohej shumë më tepër elementë të betonit të vendosura në beton. Në hapat e pabarabartë të terrenit që priten për pllakat bazë, rekomandohet një madhësi minimale e hapit prej rreth 450 milimetra (18 in). Një platformë pune kërkon që elementë të tjerë të jenë të sigurt. Ata duhet të jenë të ngushtë, të kenë binarët me mburojë

të dyfishtë dhe të gishtin dhe të ndalojnë dërrasat. Duhet gjithashtu të sigurohet qasje e sigurt dhe e sigurt.

Komponentët themelorë të skela “Jet Scaffolding” janë tubat, bashkuesit dhe dërrasat. Tuba zakonisht bëhen prej çeliku ose alumini; megjithëse ka skela të përbërë që përdor tuba të fibrave të qelqit të mbështjella me filamente në një matricë najloni ose poliestër, për shkak të kostos së lartë të tubit të përbërë, zakonisht përdoret vetëm kur ekziston rreziku nga kabllot elektrike që nuk mund të izolojnë. Nëse janë çeliku, ato janë ose “të zeza” ose galvanizuar. Tubat vijnë në një sërë gjërash dhe një diametër standard prej 48.3 mm. (1.5 tubacione NPS). Dallimi kryesor midis dy llojeve të tubave metalik është pesha më e ulët e tubave të aluminit (1.7 kg / m në krahasim me 4.4 kg / m). Megjithatë ato janë më fleksibile dhe kanë një rezistencë më të ulët ndaj stresit. Tuba zakonisht blihen në gjatësi 6.3 m dhe pastaj mund të priten në madhësi të caktuara tipike. Shumica e kompanive të

mëdha do t'i shesin tubat e tyre me emrin dhe adresën e tyre për të penguar vjedhjen. Bordet ofrojnë një sipërfaqe pune për përdoruesit e tribunave. Ata janë dru të kalitur dhe vijnë në tre trashësi (38 mm (e zakonshme), 50 mm dhe 63 mm) janë një gjerësi standarde (225 mm) dhe janë një gjatësi maksimale prej 3.9 m. Mbërritjet e tabelës mbrohen me pllaka metalike të quajtura pranga ose ndonjëherë pllaka gozhdë, të cilat shpesh e kanë vulosur emrin e kompanisë në to. Dyllat e tribunave të drurit në Britani të Madhe duhet të jenë në përputhje me kërkesat e BS 2482. Po ashtu, përdoret edhe stolisje druri, çeliku ose alumini, si dhe pllaka të laminuara. Përveç tabelave për platformën e punës, ekzistojnë bordet e vetme të cilat vendosen nën skelë nëse sipërfaqja është e butë ose që dyshohet ndryshe, megjithëse mund të përdoren edhe bordet e zakonshme. Një tjetër zgjidhje, e quajtur skatepad, është bërë nga një bazë gome me një pllakë bazë të formuar brenda; këto janë të dëshirueshme për përdorim në tokë të pabarabartë pasi

ato përshtaten, ndërsa bordet e vetme mund të ndahen dhe duhet të zëvendësohen. Skela, e quajtur edhe skelet, është një strukturë e përkohshme e përdorur për të mbështetur ekuipazhin e punës dhe materialet për të ndihmuar në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave, urave dhe të gjitha strukturave të tjera të bëra nga njeriu. Skelat janë përdorur gjerësisht në vend për të pasur akses në lartësitë dhe zonat që përndryshe do të ishin të vështira për t'u arritur.



ORDER NOW
and get 4 to 6 weeks
Free Hire
Call: 019 2351 8933



JET
SCAFFOLDING
LTD

Jet Scaffolding
Unit 212 Flexspace
5 Elstree Way Borehamwood
London
WD6 1SF

Tel: 0192 351 8933
Mob: 077 3874 0018
E-mail: info@jetscaffolding.com

**“Skela Jet” është e bazuar
në Watford, Hertfordshire dhe mbulon
të gjitha zonat në Londër.**

A NA DUHET NDONJË ESE ME ARMË?

Një ese me armë. Një ese si Bilanc lufte, nga realiteti shqiptar i vitit që lamë pas. Pra viti i kaluar u mbyll me 68 të vrarë. Nga vrasjet për drogën tek ringjallja e bandave. Dje u vra dhe një pronar televizioni lokal në Rrëshen. U vra me snajper. U vra pasi në aradhën e vrasjeve të atij qyteti thuhej se ishin vrarë dhe të tjerë... Pra është thjesht një ese me armë?! Pra, është thjesht një ese si "bilanc lufte"? Le ta themi si të duam, por është një dhimbje njerëzore, është një dhimbje shqiptare. Është... një ese me armë. Distanca më e shkurtër midis dy pikave të parabolës së udhëtimit të materialit që synon marrjen e jetës së Tjetrit. Metoda më e shpejtë për të arritur një rezultat jetëmarrës. Përgjigja më e shpejtë për një rezolutë mes një mendjeje të zbrazur dhe një koke të zjarrtë. Ikja është e barabartë. E gjithë terminologjia do të thotë në thelb e njëjta gjë: sinteza e joekzistencës. Kjo është ajo që sistemi i sigurisë për qytetarët është menduar të bëjë. Kjo është pika e kontroleve dhe

ekuilibrave, që shteti i ka propaganduar, por i ka humbur. Një kontroll është një ndalesë. Një ekuilibër është një masë. Po ku është kuptimi i politikës së marrëdhënies njerëzore? Kuptimi i politikës së marrëdhënies njerëzore... Evolucion i ka luajtur rolin e tij në psikologjinë e burrave dhe grave për zgjedhjet në lidhje me marrëdhëniet për shkak të praktikitetit mjedisor. Por a jemi ne të aftë të bëjmë zgjedhje të arsyeshme edhe në këtë pikë të zjarrtë e të dhimbshme? Logjika jonë vetë gjenerohet nga lënda organike, një tru i ndikuar shumë nga fenomenet dhe arsyet, mentaliteti i ushqyer në flakë të tmershme, hormone, testostosterone feromone, dietë, dëshirë, ajrin që thithim me hundën tonë të madhe, një filxhan çaji mes zhurmës dhe mburrjes, të gjitha thithen nga trupi ynë, baganta kimike, një sistem jehonë që është



vazhdimisht në kundërshtim me elementët e tjerë. Egoja jonë na thotë se ne e kemi çdo gjë nën kontroll dhe se bëjmë zgjedhjet tona. Pyesni veten: "Sa fëmijë i kanë parë lajmet televizive në aritmetikën e 68 të vrarëve? Sa të tjerë e kanë parë vrasjen e një Njeriu të medias?" Por vendosni duart tuaja mbi zemrat tuaja o njerëz dhe më thoni sa zgjedhje të arsyeshme kemi bërë! Ne jemi individë që përpiqemi të fitojmë pasuri dhe t'i kemi në dispozicion, ndërsa ne justifikojmë veprimet tona, që na garantojnë jetën tonë, që janë për veten tonë. Le

ta përdorim njëri-tjetrin me respekt dhe të përpiqemi të jemi më gjakftohtë, le të mendojmë më drejtë e më mirë! Fundja a nuk është dhe kjo politikë, o politikanë, madje politika më e mirë? Mendoni dhe veproni kështu dhe ne do të Ju votojmë, pa ua parë ngjyrat, madje as fytyrat, por përkushtimin tuaj. Të gjithë duhet të kujtojmë se këta vrasje, vijnë nga vrasës që planifikojnë sulmet e tyre. Kaq me një ese. Kaq me disa fjalë. Kaq me... Me çfarë? Problemi u zgjidh... ... dhe askush nuk prek një armë.

ERMAL KARAKUSHI



PËRSE DUHET TË NA ZGJIDHNI NE

- ✓ INSTALIM I PLOTË OSE I PJESSHËM
- ✓ ZËVENDËSIME TË SISTEMIT TË SIGURISAVET
- ✓ SHITESË PRIZASH/ ÇELESAT, NDRIÇIMI ETJ.
- ✓ DUSHE/ LIDHJE GATIMI
- ✓ SISTEMET E NGROHJES/ STORAGE
- ✓ SHËRBI ME PROFESIONALE ELEKTRIKE

ermal_niceic@hotmail.co.uk

Zyra: 020 8443 3833


Tel: 07568393784

INXHINIER ELEKTRIK

TË GJITHA NGA
NDERRIMI I
LLAMPAVE. NDRIÇIMI
DERI TEK SKEMAT
PROFESIONALE DHE
INSTALIMI

JO! JO, KOLEGU IM NUK TË LEJOJ TË MË TJETËRSOSH SHQIPËRINË TIME TË DASHUR!

Kam disa miq të botës Hebre. Hebrenj që kanë sensin e ndjesisë dhe përkushtimit ndaj punës, biznesit, kulturës, edukimit, disiplinës, respektit, trashëgimit dhe mbrojtjes së vlerave e traditave. Prej ish Drejtoreshës së Departamentit të Universitetit tim, (tashmë Ndjesë Pastë, pasi ka ndërruar jetë) kam mësuar më shumë, madje thelbin e fjalës “Zgjimi”. “Zgjimi” ishte pikërisht filozofia e dritës, e jetës, e hapjes me botën ku njeriu pikëtakohet me Tjetrin. “Zgjimi” ishte kuptimi që urrejtja nuk është abstrakte. “Zgjimi” ishte thelbi i abstraktes në mendjen time, se urrejtja dhe cmira janë thjesht vetëm dukuri, dhe bashkëjetesa e tyre me Njeriun e mirë ishte kotësi. Por urrejtja, ashtu sikurse dhe cmira u shfaqën para syve të mi, në jo pak raste, në mënyra fizike dhe të prekshme, përtej fjalëve dhe dukjes, përtej mediave dhe debateve, dhe vërtetoi se mund të arrijë edhe në komunitetin tim të afërt. Kjo menjëhershë, që urrejtja mund të shfaqej nga afër, ose që një komunitet mund të përdhosej, ishte ajo që më mundonte. “Zgjimi” im zbuloi një botë të zymtë. “Zgjimi” im më solli dritë në errësirën e heshtjes, mospajtimit me gjërat dhe frikën, në emër të respektit dhe kulturës. Është interesante që unë u mësova ta parashikoja këtë errësirë në një moshë shumë të ndjeshme. Kam shkruar më parë për këto dy fenomene, para se të kuptoja kuptimin e tyre. Urrëjtja ishte ajo që unë e kisha dëgjuar të përmendet si “urë e ngushtë” në “Kol Ha'Olam Kulo”, një këngë të cilën e kisha kënduar pa e kuptuar me miqtë e mi hebrenj në disa nga takimet festive dhe miqësore me ta. Vonë



teksta e rikëndoja me disa prej tyre, mësova se teksti i këngës pohon, “E gjithë bota është një urë shumë e ngushtë dhe gjëja më e rëndësishme është të mos kesh frikë kurrë.” Dhe kjo ishte e habitshme, miqtë e mi hebrenj më tregonin se madje ishte: “një nga këngët e parashkollave të hebrenjve që mësojnë fëmijë gjashtë vjeçar, e cila parashikon një botë të frikshme, ku frika është e paracaktuar, dhe mos-frika është një vendim aktiv”. Para disa kohësh këtë këngë m’u desh ta dëgjoja me disa miq të mi të komunitetit shqiptar, drejtues dhe aktivistë në Britani të Madhe, ku ishte i pranishëm dhe ish-Ambasadori Zef Mazi, në mjediset e Parlamentit të Britanisë së madhe, ndërsa po shfaqej një dokumentar i inicuar për shpëtimin e Hebrenjve në Shqipëri. Dhe aty ish-Drejtoresha e Departamentit tim, do të më sqaronte se ta këndosh këtë këngë (dhe në vendet më të pazakonta) duhet natyrshëm që të rishikosh edhe tekstin e këngës. “Unë isha duke qëndruar në oborrin e një shtëpie private në Tiranë, Shqipëri, nën një tendë të ulët të endur nga degët e pemëve mandarinë të oborrit. Shtëpia i

përkiste një burri shqiptar, i cili kishte shpëtuar një hebre gjatë Holokaustit dhe ishte nderuar nga Yad Vashem vite më vonë si një xhentëlmën i drejtë. Për të nderuar kujtesën e tij, grupi im vizitues me këngën në fjalë konfirmoi se bota ishte një urë shumë e ngushtë.” “Si mund të këndonim që bota ishte e ngushtë dhe e frikshme përballë njerëzve, që kishin rikthyer pak shpresë, të cilët e bënë botën të duket pak më e frikshme?”, E pyeta veten time. Ajo që më goditi atë ditë ishte se ishte botëkuptimi im, jo vetë bota, që ishte në këtë qesëndosje dhe shtrirje të ngushtë.”, ishin fjalët e saj që më kumbojnë ende si të freskëta, fjalët që ia tha dhe ish-Ambasadorit të Shqipërisë në bisedë e sipër. Tani, disa vite më vonë, këtë këngë e ridëgjova nga larg dhe pashë vërtet se ura që lidh këtë shpresë me vargje të kohëve të fundit të krimeve të urrejtjes që ka pushtuar disa media britanike për shkak të disa “keqbërësve” dhe që bëhen si shembull për të sharë vendlindjen time është ngushtuar, dhe kam vërtet shumë frikë, se brezat që rriten larg vendlindjes, ose që vijnë nga rrënjët e vendlindjes sime

të dashur, Shqipërisë, vendit që me shembullin dhe guximin e të parëve të mi, vrau frikën dhe shpëtoi Hebrenjtë nga Holokausti, do të humbasin ndjenjën e dashurisë, dhe do të kenë frikë të ndjehen anëtarë të denjë të kodit më krenar të shqiptarit “Besa”. Pse duhet të heshtim, për “keqbërësit”? Por pse duhet të shajmë një Komb të tërë për hir të atyre tek të cilët vepron ligji? Pse duhet sharë shqiptari i mbarë dhe i mirëintegruar, shqiptari model?! Jo, kolegë të nderuar. Jo! Ne nuk mund të pajtohemi me këtë. Populli im që shquhet për proverba, Fjalë të Urta, ka dhe një të tillë: “Për një dru të shtrembër nuk mallkohet një pyll i tërë!” edhe pse e dimë fort mirë që një “shkop i shtrembër e prish stivën”. Kjo e fundit është edhe tek “Zgjimi” ynë kolektiv i komunitetit, që duhet të shembullohet nga hebrenjtë dhe ndjesia e përkushtimi i tyre, sikurse është fjala e tyre “mitvah”, një fjalë që në kuptimin e saj parësor, i referohet parimeve dhe urdhërimeve të urdhëruara nga Zoti, me kuptimin shtesë të detyrës morale dhe njerëzore të një personi.

VILA RONEL



Vila Ronel Bar
& Restaurant
46 Birchington Road
London
NW6 4LJ

020 7624 1385

www.vilaronelrestaurant.co.uk

Reservation@vilaronelrestaurant.co.uk



HAKMARRJA E DIKUNDIT

Në librin e tij “Rruga për diku tjetër”, shkrimtari britanik David Goodhart identifikoi dy ekzistenca të gjera politike, ata që shohin botën nga Kudo dhe ata që shohin botën nga Diku. Fitorja e mandatit të dytë prej Edi Ramës dhe më së shumti dalja nga Parlamenti i sotëm i PD-së dhe Opozitës e ka sjellë edhe një herë këtë ndarje në sipërfaqe.

Sidoqoftë, Kudogjendësit, sipas leximit të sotëm në mjedisin politik shqiptar, duket se kanë tendencë të jenë më të rinj dhe t'i kushtojnë më shumë vlerë karrierës dhe arsimit, domethënë, ata e shohin veten “në kuptimin e asaj që kanë arritur”. Ata gjithashtu janë më të rehatshëm me diversitetin e sotëm politik dhe nuk “bëzajnë” fort për largimin masiv, pikërisht sepse identiteti i tyre është më pak i vendosur në vend dhe grup. Dikundësit në të kundërt, disi janë më të vjetër dhe kanë vlerë më të madhe në komunitetet që ata përfaqësojnë, edhe ku jetojnë. Kjo nuk do të thotë që Kudogjendësve nuk u intereson komuniteti i tyre. Përkundrazi, Kudogjendësit mund ta shohin veten duke përparuar në çdo komunitet. Goodhart vlerëson se rreth 50 përqind e popullsisë janë Kudogjendësit, 25 përqind janë Dikugjendësit, dhe pjesa tjetër zënë zonën gri midis dy kampeve. Të dy botëkuptimet janë krejtësisht të ligjshme, por problemi është se ato mund të bien ndesh mjaft lehtë me njëri-tjetrin.

Nga bisedat dhe dëgjësat pranibërëse, të gjitha të mbushura me politikëbërës, politikanë, gazetarë dhe akademikë, Goodhart u bë me dije të dhimbshme, se

si pikëpamja Kudogjendëse mbizotëron në diskutimin publik, pavarësisht se është një pikëpamje e pakicave.

Këtë e përjetova vetë kur ndoqa Forumin e Fondacionit “Konrad Adenauer” në Elbasan vite më parë. Ai zhvillohej në kuadrin e trajnimit të politikanëve të rinj me format më demokratike, si dhe shërbente si një tërheqje për njerëzit me ndikim në fusha të ndryshme, që të takohen dhe diskutojnë për politikën në liri dhe demokraci. Forumi dukej në plan të parë si një shtysë e dikurshme nga ajo që ishte krijuar nga Helmut Kohl dhe Margaret Thatcher në vitin 1985 për të nxitur marrëdhënie më të mira midis elitave të ardhshme të Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, pasi në fakt edhe në takime të ndryshme vihej re një lloj interesimi për elitat.

Asokohë ndodhte në një vit para zgjedhjeve të 26 majit 1996-të dhe uforia politike i kalonte anës së Djathtë, asaj që dukej sikur po rrokte elitarizëm në sfondin politik. Të pranishmit ishin biznesmenë, nëpunës civilë, njerëz dhe intelektualë të mendimit dhe akademikë, të gjithë të rinj, apo të rinj në një mjedis të atillë të ri për të gjithë. Unë kam qenë një nga të paktët e medias atje në atë seminar që do të bëhej mjaft interesant në mjediset e ish-Turizmit “Skampa” të Elbasanit, ende të paprivatizuar. Ishte një grup i pranishëm i interesuar, të cilët ishin përkushtuar duke mbajtur shënime të arsyeshme dhe të mbajtura mirë, por shumica ishin në gjendje “shoku” dhe “mërzie” dhe po kërkonin të shfrytëzonin kohën si një lloj seance terapie kolektive.

Sesioni i parë në seminar

përfshiu edhe një pjesë të socialdemokracisë dhe republikanëve lokalë të asaj kohe, të cilët ishin dhe arkitektët e aleancës së parë fituese në krah të PD-së pas zgjedhjeve të fituara të 22 Marsit 1992 dhe po atë arkitektët e bojkotit të parë politik shqiptar. Më bëri përshtypje kjo e fundit. Megjithatë isha i kujdesshëm me shumë prej politikanëve të lidhur me diskutimet, aleanca e atëhershme PSD dhe PR (me siguri me urdhër nga liderët e Tiranës) bëri disa pika krejtësisht të arsyeshme. Pasi ata mbetën të pakënaqur dhe ishin larguar, ne u ndamë në grupe për të diskutuar atë që kishim dëgjuar. Menjëherë, aktgjykimi ndaj pyetjeve të tyre ishte se ata ishin “oportunist dhe sharlatane”. Por kjo u tha vetëm pasi ata ishin jashtë sallës dhe veshët e tyre ishin diku në kabinën e afërt të Postës, ku duhej të merrnin konfirmimin e Gjinushit dhe Godos.

Më vonë, biseda u kthye në vlerat demokratike, vetë ideja e së cilës ngjalli interes dhe debat. U bënë referenca derivative për mjaft lidhje dhe ndërlidhje strukturore demokratike. Ndërkohë, këta elitarë diskutuan se si mund të futim vlerat demokratike evropiane në pjesën e madhe të politikave, nga pika jonë e këndshme e favorshme në mjedisin rural, ku ende mediat nuk kishin kapërcyer të shkonin në dyert dhe vatrën e tyre. Mediat, atyre që kishin ardhur me mjekra të bardha, nuk u dukej se ishte problem. Gazetat? Mediat? Ata nuk e konsideruan që mund të ishte pak vonë për këtë. Diskutimi u kthye në mënyrë të pashmangshme në atë se si ne mund të krijojmë një politikkë të re

dhe të mbajmë gjeneratat në afërsinë e duhur, jashtë zhgënjimit masiv të tyre.

Seminari u duk qartë se u mbizotërua nga Kudogjendësit, me ton të shurdhër ndaj zërit që u shfaq si diku dhe dikur. Diversiteti i mendimit mbi ofertën u përmbledh nga një diskutim i vendosur për ne midis një pale që kishte dosjet nën sqetull nga Tirana. Në fund të seminarit, ne u kërkuam të jepnim mendimin tonë për procedurat. Unë thashë se e gjithë çështja ishte si të shikosh një ndeshje futbollit midis “Labinotit” (emri i ekipit të futbollit deri në vitin 1991) dhe “Sport-Klub Elbasanit” emrit të ri të ekipit të futbollit. Kjo mori një të qeshur.

“Sport-Klub Elbasani” ndihet si një metaforë e përshtatshme për elitat tona të asaj salle, ata vendosën ritmin, tani ata janë lodhur, duke dështuar dhe duke u përpjekur në mënyrë të dëshpëruar të rimarrin epërsinë e tyre. Elitat e përfaqësuar në ngjarje si këto nuk janë elitat që shfaqen në televizion, politikanët ose komentuesit. Këta janë njerëzit pa bëmë, pa nam për të cilët nuk keni dëgjuar kurrë, por që ushtrojnë ndikim shumë të madh në bërjen e politikave. Janë ata që merrnin tenderat dhe paratë, ata që sot heshtin dhe presin të rimarrin rolin e tyre në këtë rrokadë. Prioritetet e tyre shpesh nuk janë në përputhje me publikun, dhe ata shpesh nuk janë njerëz shumë të njohur. Elita jonë Kudogjendëse ka diktuar një strukture të paparë në kutitë e votimit të viteve të fundit: në Zgjedhjet e Përgjithshme dhe po atë dhe në Zgjedhjet e Pushtetit Vendor. Edi Rama ka shfrytëzuar me sukses impulsin Dikugjendës, diku brenda dhe jashtë elektoratit.

Endej se luaj me fjalë, me shkrim e me gojë, sikur zëri im të jetë ende ai zë në ekranin e Televizionit të parë privat shqiptar “Dardan” dhe fjalori të ketë dalë nga skutat e harruara të Fjalorit të Kostallarit, apo nga grumbullimet masive të fjalëve të ralla. Si një hiperbolë letrare e rregulluar, siç duhet për të shpjeguar në mënyrë të përsosur këtë brutalitet të prishur, e ndjek fjalën e bukur shqipe në tensionin e saj të shpërfilljes nga gjuhërat e tjera, të qena e të paqena në udhëjetën ku ndeshim avionë, trena, autobuzë e mbi të gjithë udhë pa udhë në integralin Botë.

Forcoj gjuhën e bukur shqipe dhe arsyetoj në gjuhën angleze, që kjo zhduqëllësi të punojë për mua, si një kohë veçanërisht e duhur për të ndriçuar sadopak pjesën e errët në histori. Dhe duke u marrë me kujdes me optimizmin e mashtimit të gjuhës dhe sulmet në mënyrë agresive nga ndonjë fjalor me zë dhe personalitet, tek i cili rrëndon vetëm zyra, kolltuku, kuleta apo... edhe e rishtimja ‘...kjo është jeta, or tungjatjeta!’

E ndej një “Jo” fizikisht, por

edhe një pengesë në psikikën e tillë e të huaj, pothuajse psik-hedelikisht (psiko-kokore) ku më duhet jo pak herë të gjej e të përdor fjalë mjekësore, si një kirurg me profesionalizëm e të mbjell mendime duke pëshpëritur butë, por me bindje: Lëvizja e letrave është



si shahu, është një fushë që kërkon për të shprehur mendimet me mjeshtëri dhe kreativitet, e pse jo edhe një fushë për mendime groteske, por të mrekullueshme, të shkruara bukur.

Miq të letrave dhe të shkrimit, të fjalës së bukur shqipe e të krijimtarisë, Ju mund të ndihmoni, që të bëjmë bashkë një zërim të madh, që të

ABUZIM VERBAL

dëgjojmë hutimin e fjalëve të vendosura në mënyrë mitike, me një shok postmodern të ditëve tona.

Një e çuditshme me guximin për të ngritur shiritin e harruar të ndonjë magnetofoni të

unë po Ju shkruaj.

Unë nuk jam një pemë e rënë, as një trung i prerë, as edhe një shkarpë e ulur në pyllin e zhurmshëm në heshtje, në heshtjen që për ne të gjithë ndërtohet heshtazi ajo që varet nga vetmia dhe nga shkujdesja. Është e kundërta në të vërtetë dhe faktikisht, me një dialekt aq të dhunshëm nderohet vetëm ajo që vetëm mund të mbetet frikacakisht dhe automatikisht një arsye e shkrimit.


Nuk më duhet thjesht të ngre një problem, që më duket se mbetet problematik...

Miq të nderuar, lërimi fjalët e mia të qëndrojnë atje në ajër si tym, le të shkojë kjo fjalësi si një tym i trashë dhe ngjitet në mjegullnajën e sotme. Por ju lutem periodikisht kthehuni për të parë dhe të shihni nëse e keni kuptuar misterin e këtij tymi? A e gjetët çelësin?

Kurrë nuk mund ta kisha planifikuar, shikoni, se duhej të ndodhte natyrshëm, në mënyrë organike nëse do të kisha harruar zërin tim, nëse do të më duhej të harroja Fjalorin e Gjuhës së bukur Shqipe. Dhe jo ta kërkoj në mënyrë të rreme.

vjetër dhe duke ngritur kapacitetin e ndonjë libri me kapakë të shkyera, por që kanë vlera dhe janë mjaft vepra të vyera.

Sepse ajo që del nga unë duhet të jetë pikërisht ajo që shihni, sepse është jo thjesht një “unë”, jo vetëm një pjesë e imja por e asaj që të gjithë kanë lënë tek mua, që nga lindja e deri në momentin që



POEM
Bar & Grill

AVAILABLE FOR HIRE
120 ADULTS & 60 CHILDREN

NJË FUND SI NJË FILLIM LEXIMI

Errësira nuk këmbëngul të çapitet, as të vendoset shpejt pas perëndimit të diellit. Shkon tutje në bregun e saj të mëkatit të turbulluar, sikurse ndodh në një ditë me shi e me re të dendura, në rrugëtimin drejt e në kthim nga Hygh Whycombe. E tillë është errësira. E lexueshme ndoshta në ngjyresën e saj me kapakët e rrëfimeve nga ferri të Miho Gjinit, ku “Arratisja e Kujtesës” shkon shkitazi në mbi njëqind e pesëdhjetë faqet e saj brenda një bote tjetër. Në leximin mendjengulës, teksa pjesa metalike e vendosur mbi goma të ndjeshme, shket në asfaltin e lagur, e dritat bëjnë tutjerendjen e errësirës, kjo mëdyshje botërash e bën botën brenda këtij libri, ndryshe nga sa e ndjen edhe nën shiun tipik anglez, i cili mes leximit të kaftis dhe të bëhet një rrebesh më i ftohtë, por që mbetet i dromcët, me qëllim që shpirtrat e lodhur të pushojnë. Dhe sikurse ndodh e kthen nga fillimi

në fund, para se sytë të bëhen palë me moslargimin e leximit. Aty ndjen pjesë të trazuara e të ngulitura bukur mes shkrimit, ku natyrshëm ndodh rallë të lexohet, veçse kur has me emrin e Visar Zhitit. Dhe pastaj..., pastaj sytë ngulen dhe pasojnë shkrimin si në një transportier elegant në memorje. Në këtë hapje-mbyllje të menjëhershme, sigurisht kureshtare, dhimbëse në qasjen kronologjike, me simetrinë dhe dalldisjen e kohërave, duket sikur errësira shtyn me forcë në përfundimin e një cikli tjetër, ku përkushtimi shkon për shokë bashkëvuajtjesh: Halil Laze, shkrimtar, Viktor Stratobërdha, kinoregjisor, Teki Biçoku, akademik, Eqerem Biba, përkthyes, Edision Gjergo, piktor, Enver Likmetaj, aktor, Kasem Trbeshina, shkrimtar, Mihallaq Luarasi, regjisor, Minush Jero, Dramaturg, Maks Velo, poet, shkrimtar, Frederik Rreshpja, poet, shkrimtar, Visar Zhiti, poet,

Zyhdi Morava, shkrimtar, Milto Vako, dirigjent, Mehdi Prodani, muzikant, Zef Lekaj, kompozitor, Dhimitër Furzhi, aktor, e dhjetra, qindramijëra të tjerëve që përjetuan tragjikisht rrathët e ferrit nën diktaturë. Por sot, në një truall tjetër, është vetëm leximi dhe ngutja dromcake e shiut që bashkohet në risi-sinfoninë e errësirës, që pret një natë, që sipas gjasave të mot-treguesve, gjoja të mbuluar në yje, të cilët lahen në galaktikë me madhësinë dhe dritën e tyre, që nuk lexohet shkitazi dhe duket se ato nuk ndodhen, e nuk janë askund brenda faqeve të rrëfimeve nga ferri. Mbi të gjitha, përveç rrëmujës që dashur e pa dashur shkon në cila të ujëta mbi xhama, ajo që bashkon në lexim e në udhë të tillë, ulërin erën në trishtim, duke zbuluar mes letërkëmbimit me Bekim Fehmiun, një dimër të fortë, të trishtuar, që ngjashmërinë e ka me shirrat e trishtuar, por jo me tetorin anglez të

kësaj vjeshte, 2019-të. Fjala e fillesës në lexim dhe zhurma e ngasjes shirrnanake, e të zhurmshme në këtë ndryshim, forcon bindjen se autori duke mos dashur të humbasë shkëlqimin e fjalëve të parathënies dhe shkëlqimin e atyre që i sjell me intuitë, i ka qëmtuar në formën më të mirë të mundshme për të formësuar pasionin dhe energjinë, me një shkrim tejet të qartë, gjuhë të bukur, rrjedhë të ndjeshme leximi, arsye që lidhen me vetë arsyet: “I dashur Bekim! Më lejo të të thërras kaq thjesht e të të quaj “i dashur”. E ndjej veten të vetmuar, të harruar nga bota, por kur përmend emrin tënd sikur bëhem më i fortë e sikur gjendem më pranë dashurisë njerëzore.” Një stilolaps i lodhur duke regjistruar këto ngjarje “rrëmbehet” me rendin e tij, dhe errësira shkon “e zhytur afro dy metra nën tokë” ku autori i këtij libri thotë “shoh fare pak qiell, edhe atë të copëtuar nga hekurat e dritares...”.



+



PROFESIONALIZËM • GARANCI • CILËSI



**ABONIME
INSTALIME
RIMBUSHJE**

PËR MË SHUMË KONTAKTO GËZIMIN: 078 157 359 45

NJË BISEDË QË SAPO KA NISUR ME BIZNESMENIN E SUKSESSHËM AQIF NELI

Është e vështirë ta gjesësh në zyrën e “AN Construction Solution Limited”, kompanisë së tij, drejtuesin e saj Aqif Neli, pasi ai është gjithnjë në mesin e të punësuarve të shumtë të tij, në mesin e fronteve të reja të punës. Por në një orar të tillë të gjithë thonë se e gjen vetëm aty. E gjen por në krye të një paneli ku ai ka pikënisjen parësore të punës me tre elementët kryesorë e të domosdoshshëm të një suksesi: Shëndeti dhe siguria, Produkti dhe Cilësia.

Ndërsa sheh pamjen estetike të zyrave, qasjen profesionale e dikton me tërë dokumentacionin që mbetet në sytë e tu një model më vete. Pastaj me respektin e stafit dhe të vetë drejtuesit, natyrisht. E gjitha është një vizitë dhe një bisedë që shkon në shtratin e saj, pas disa vitesh njohjeje të largët nga kjo zyrë...

1. Jo më kot thuhet se një rastësi mund të udhëtojë gjysmën e botës, ndërsa një sukses është duke veshur çizmet e veta. Sa

e vërtetë që është sot kjo në epokën e mediave sociale, në epokën kur fjalët e trashëguara dhe ata gjëra që na kanë rritur e edukuar tashmë janë në një hapësirë të gjerë e të bollshme digjitale. Konsideroni stuhinë e vrullshme të njerëzve të përqafuar mes suksesit dhe talentit, mes një disipline nga fëmijëria dhe disiplinës në rritje të përditshme. Dhe fare thjesht, mjaft lehtë ajo që shkon në një bisedë është pikërisht lidhja me të cilën njeriu kupton, se suksesi është tek ai që krijon dhe forcon personalitetin e tij. Kështu ndodh në jo pak raste. Ndodh kështu pasi në mjaft raste gjëja e parë që njerëzit vërejnë për njerëzit e suksesshëm është, veshja e shtrenjtë, makina luksoze, jetë të ndryshuar, familje me teprica shpenzimesh etj. Kur njerëzit nuk ulin sytë të shohin se njeriu i suksesshëm është vetë ai që ka lindur dhe ardhur në këtë pikë nga puna,



disiplina dhe angazhimi i përditshëm me bindjen për të bërë më të mirën për veten, familjen dhe tërë shoqërinë. Dhe kur ndodh ndryshe vërtet edhe shkrimi shkon më gjerë në shtratin e duhur...

2. Dhe këtë e mëson mjaft mirë, qoftë edhe në pak minuta. Pra, në disa minuta me biznesmenin e suksesshëm shqiptar, Aqif Neli, intelektualin që në jo pak raste ka merituar fjalët dhe respektin më të lartë komunitar dhe britanik në fushën ku ai tashmë operon me kompaninë e tij prej vitesh. Në një ambient pune ku diskursi i gjërave rrek estetikën e të gjithë panoramës dhe me një modesti të shtjellët respekti kupton se njeriu i suksesshëm mësohet nga udhëtimi i tij, jo nga destinacioni. Mësojmë se si arriti atje, pikërisht në majën e suksesit, duke kuptuar gjatë bisedës se sa vështirësi i është dashur të kalojë e kapërcejë me durim e përkushtim për të arritur ku është sot me një stendë që

flet vetëm për certifikata, vlerësime, dedikime dhe mbi të gjitha për rezultate e cilësi. Në atë bisedë mëson mes qetësisë se çfarë bëjnë njerëzit e suksesshëm si intelektual i plotësuar Aqif Neli. Në atë bisedë të sinqertë mëson pse disa njerëz janë më të suksesshëm se të tjerët. Dhe në atë bisedë dalin në pah disa nga karakteristikat me të cilat fare lehtë kuptohen historitë e njerëzve të suksesshëm.

3. Tek një bisedë e tillë shkon fjala tek vizioni. Dhe në këtë pikë vizionari nuk është aspak ndryshe nga biznesmeni shqiptar, Aqif Neli, pasi thjesht dhe qartë kupton se njerëzit e suksesshëm gjithmonë mund të parashikojnë, se çfarë do të jetë udha e tyre, si do të shkohet në atë udhë dhe cili do të jetë rezultati i asaj udhe. Kupton fare qartë se të tillët mund të vizatojnë një pamje të qartë të asaj, që do të jetë jeta e tyre dhe çfarë duan të arrijnë. Në këtë rast mes bisedës të shoqëron pyetja: “Kur mbyllni sytë, cila është jeta që fotografoni për veten tuaj?”





Dhe për Aqif Nelin është jeta që nis larg në Atdhe me bukuritë e memorjet mes gjashtë fëmijëve vëllezër e motra të një familjeje me gene patriotike dhe disiplinore atdhedashëse, ku u rrit vetë protagonistin, që babai i tij Nel dhe nëna i rritën të mbeten modele për të gjithë. Aty, Aqif Nelin, i kujtohen mjaft gjëra që ushqyen vizionin e tij që në fëmijëri. I kujtohen të gjitha dhe në disa raste edhe përletet. E ndjen se ende ka për të shkuar më tej mes këshillave të vlefshme familjare. E ndjen se ai tashmë duhet të shkojë në atë që ka mbajtur në zemër e në mendje.

4. E më tej ai e di se qëndrimi i përqendruar, kërkon që njerëzit e suksesshëm të marrin hapat e nevojshëm për t'i ndihmuar ata të qëndrojnë në rrugën e duhur, të shmangin

shpërqendrimet. Ata nuk bëjnë justifikime. Ata marrin një detyrë dhe e mbajnë atë deri sa të kenë arritur rezultatet e dëshiruara. Rezultatet nisin qëkur dhjetat e shoqëronin përditë në shkollën e vendlindjes dhe më pas e ngritën deri në nivele të larta specializimesh. Studenti i shkëlqyer, kandidati për pedagog në një nga universitetet më prestigjioze të kohës, i mirëspecializuar në një vend mik të NATO's ndoshta dhe deri tek niveli më i lartë i kualifikimit Degree në fushën e konstruksionit në Britani të Madhe etj. Duke shkuar më tej të gjitha që janë në dosjet e vlerësimeve të kompanisë janë faktor dhe rezultat i gjatë dhe i ndjeshëm.

5. Pasionant, nuk është vetëm një pjesë që e shtyn tek suksesi biznesmenin Aqif

Neli. Janë shumë arsye që nisin nga elementi më i thjeshtë, njeriu intelektual i specializuar në personel, rezultatet e larta, puna si manaxher, kontraktor, disa nga pasionet që e kanë shtyrë në jetë jo vetëm që të jetë i suksesshëm, por dhe një model komunitar. Kur flasin për punën ose jetën e tij, fytyra e tij ndizet dhe na tregon se ai vetë nuk mund të flasë për veten, por për pasionet e tij. Ai është si të gjithë ata që e duan atë që bëjnë. Ata kanë një sens të fortë të përkatësisë në

jetën e tyre. Bashkëshortja e tij, doktoreshë Vali, natyrisht është një pjesë e suksesit që bashkohet përtej pasionit të kësaj familjeje të nderuar komunitare.

6. Për Aqif Nelin në bisedë gjithnjë është shembull vetë adekuatja "Qëndroni pozitiv!". Dhe ai e thotë qartë këtë "ju nuk mund të jeni të suksesshëm, nëse mendoni se suksesi nuk mund të arrihet. Një person pozitiv gjithmonë beson se ka një mënyrë dhe se gjërat

PRICING	ON GOING JOBS	RETENT
1 WOLD WAR OFFICE/AMB	1 MAGNACARIA ROOFING	
2 W BUCKLE STREET/BENNETTS	2 YORKE PLACE	
3 W FORTUNA THREE RAGE/MD	3 WINDSTENLEY	
4 W BLOKS, C WINDSTENLEY/MD	4 ROYAL MINT	
5 W LOTS ROAD/MIDGARD	5 PARK CHRESCENT	
6 W KINGS CROSS/MIDGARD	6 BARKING WHARF	
7 W MILHABROUR/MIDGARD	7 FULHAM WHARF	
8 W ASHLEY GARDEN/KORNAW	8 LOTS ROAD -	
9 W FULHAM WHARF/DEING	9 STATION ROAD -	
10 W H1 WATERBORO/FRN	10 WEMBEY HILL	
11 W STATION ROAD/MIDGARD	11 BEROL JARD	
12 W NINE ELMS / J RL	12 BOVES HOUSE	
13 W BARKING WHARF/TERRACES	13 HOLIE STREET	
14 W WEMBEY / W JONES	14 LENOX GARDEN	
15 W ST' RAULS SCHOOL	15 NINE ELMS	
16 W	16 KELBURN A ROAD	
	17 NOBLE HOUSE	
	18 FITZJOHN'S AVENUE	
	19 CARACAGE HOUSE	

punën e tyre, familjeve të tyre në çdo sferë të jetës. Ndaj dhe kanë edhe familje model. Në rastin konkret një dashuri e largët bashkëshortore dhe një familje me dy fëmijë të talentuar dhe model në

do të përfundojnë punën në fund. Në shumicën e rasteve ju jeni armiku juaj më i keq duke strehuar mendime negative, se pse gjërat nuk mund të bëhen në vend që të përqendroheni dhe një gjë e vogël që do t'ju çojë atje ku duhet të jeni".

Ai e nisi me punën, përkushtimin, gjuhën angleze dhe më tej me marrjen e një qëndrimi pozitiv për suksesin e sotëm të "AN Construction Solution Limited", si një kompani model dhe mjaft e vlerësuar. Më parë ishin pedagogët e tij në Atdhe dhe këtu në BM që shihnin tek ai pozitivitetin mbi të cilin edhe e vlerësonin dhe e propozonin më lart.



7. Ndërsa bisedojmë dhe fjala shkon në shtratin e saj, shohim se Aqif Neli është vetë nxënësi për jetën, që nënkupton se njerëzit e suksesshëm nuk pranojnë të qëndrojnë i njëjti person që ishin dje. Ata vazhdimisht përpiqen të rriten në punë, mbi veten e tyre, në marrëdhënie, në intelekt, në njohuri, në vlerat shpirtërore. Ata kanë njohuri dhe për ngjarjet çfarë po ndodhin në qytetin e tyre, vendin, botën dhe universin përreth tyre.

Aqif Neli lexon përditë, dëgjon përditë, jep mendime dhe shënon të gjitha gjërat, ai madje lexon 500 faqe çdo ditë. Dhe është dashamirësi i medias, librave (edhe librave të mi, pasi ka blerë disa prej tyre). Ai është mjaft aktiv dhe me komunitetin pasi edhe kjo e bën të jetë i tillë. Ai është Kryetar i Bordit të "Mother Tereza Albanian Union".

8. Dështimi, nuk është një arsye që e shqetëson. Aqif Neli e di se "Njerëzit e suksesshëm nuk kanë frikë të dështojnë. Njerëzit e suksesshëm pranojnë dështimin dhe ecin përpara. Ata nuk heqin dorë pa marrë parasysh rrethanat. Ata mësojnë nga gabimet e tyre, por kurrë mos harroni atë që u mësoi atyre." A nuk tha Steve Jobs se ideja e vdekjes e motivoi atë të mos i frikësohej kurrë dështimit?

9. Asnjë zëvendësim për punën e vështirë, është një moto e kompanisë që ai drejton. Dhe na thotë: "Ju mund të mendoni se njerëzit e suksesshëm kanë pak fat me ta, por ata krijojnë fatin e tyre duke punuar shumë. Ata besojnë nëse punojnë shumë, nuk

kërkojnë fat. Ata besojnë në krijimin e fatit të tyre, në vend që të presin që gjërat të ndodhin. Ata e dinë që nuk ka asnjë zëvendësim të punës së palodhur. Ata vendosin ditën e tyre më të mirë të ditës, derisa të marrin rezultatet e dëshiruara."

10. Në tërë atë që ai ndikon dhe u mëson të tjerëve është modeli: "Ndhmoni të tjerët të jenë të suksesshëm". Njerëzit e suksesshëm i shtojnë të tjerët drejt suksesit. Ata kurrë nuk kërcënohen nga sukcesi i të tjerëve; në vend të kësaj ata motivojnë njerëzit të jenë versioni më i mirë i vetvetes. Kur është hera e fundit që keni ndihmuar dikë të jetë i suksesshëm? Kjo pyetje i bën të gjithë krenarë tek "AN Construction Solution Limited".

11. Një ëndërrimtar, nuk është thjesht një rastësi. Ndërsa shumica e njerëzve janë të qetë duke qenë në një rutinë, njerëzit e suksesshëm si Aqif Neli, guxojnë të ëndërrojnë. Ata marrin rreze të llogaritura për të realizuar ëndrrat e tyre. "Nëse mund ta ëndërroni, mund ta bëni atë", na ka mësuar Ualt Disney.

12. Integriteti, ëshë themeli ku "AN Construction



Solution Limited" ka një nga atributet më të vlerësuara të një personi të suksesshëm. Kur ju vetë keni Parime të larta morale dhe etike është ajo që ju përcakton, mbetet efikase na thotë Aqif Neli. "Integriteti është thelbi i gjithçkaje të suksesshme.", thotë R. Buckminster Fuller, ndërsa C.S Lewis shprehet se "Integriteti po bën gjënë e duhur edhe kur askush nuk po shikon".

13. E fundit në këtë bisedë, që sapo ka nisur dhe që do të vazhdojë më gjatë në disa pika të tjera është terminologjia "Mirënjohje". Njerëzit e suksesshëm, sikurse është tashmë z Aqif Neli prej disa vitesh, janë gjithmonë falënderues për

marrëdhëniet, jetën e tyre, mirëqenien e tyre, familjen, punën e tyre dhe lumturinë e tyre. Ata kthehen pasi janë falënderues për atë që kanë marrë. "Kur është hera e fundit që falënderove dikë?", vjen pyetja e fundit për Aqif Nelin ishte kur ai u vlerësua Ambasador i Paqes në Londër, nga Federata e Paqes Universale (FPU), në një ceremoni solemne e festive, ku ai midis disa të tjerëve u vlerësua për arritje e merita të tij përkushtimore e përbushëse në kriteret e përcaktuara nga kjo OJF Ndërkombëtare me Status Special Konsultativ pranë Këshillit Social-Ekonomik në OKB.



DITËLINDJA E KULLËS, NJË NDALESË URIMI DHE RESPEKTI

Ende takimi dhe koha me mikun e rallë, Pëllumb Kullla, në sytë dhe në mendjen time ka mbetur si arti i komunikimit me të pazëvendësueshmin Pëllumb Kulla. ai është i tillë në të gjitha ditët e vitit..., pasi thuajse në të gjitha ditët ai i dhuron lexuesit grimca nga magjia e tij e krijimit, nga perlat e talentit të tij të veçantë e të ndjeshëm. Por për ditëlindjen e tij duket se na takon në të gjithëve, të rikthejmë sadopak atë që “kulla” na fal ... Dhe kjo është një ditë në ditët e viteve të tij...

Një ditë tjetër që vjen një herë në vit. Një ditë për Ju, për Ju, dhe në fakt jo vetëm për Ju. Se Ju i nderuar mik, koleg, shkrimtar dhe Njeri i Letrave, i përkisni një familjeje të madhe, një shoqërie të gjerë, një popull të tërë. Dhe numrat në këtë ditë që pason ardhjen në jetë më 10 janar 1940-të, duket se janë vetëm numra festivë. Ndjaj dhe ju festoni këto numra, që të gjithë vazhdojmë t'i numërojmë, duke kujtuar sa më shumë jetojmë me krijimtarinë dhe vlerat, me humorin dhe të qeshurat, me thumbimin dhe profesionalizmin, me shkollën serioze Kulla për brezat që rriten dhe do të vijnë, aq më shumë ndajmë ato mesazhe që ka lënë për ne përmes artit. E ndërsa kthehemi tek mesazhet duket se gjithnjë ato na diktojnë, atë që ju ndani për zemërsisht gjithmonë: “Mos harroni miqtë dhe familjen tuaj, duke i mbajtur afër, pasi ata do të jenë me ju gjithmonë në trup, mendje dhe shpirt. Do të arrini atje ku po shkon, në gjatësinë më të madhe të jetës, megjithëse një udhëtim akoma më i gjatë ju pret akoma në vitet e ardhshme”. Të Kuqe. Blu. Balonat kalojnë nga dora në ajër. Lidhja e tyre e tërhequr meton në tela përkujdesjen e fjalëve që mbartin, urimet

për ditëlindjen, që nisin me tabakanë e kafesë së humorit të “kafesë së Zenepesë” (O moj Zenepe sa e mirë që je) dhe shestohen me prerjen e tortës së ditëlindjes, ose shkrirjes së akullit të qindra grimcave të humorit, që u ndanë dhe shkulën së qeshuri artistë e shikues, miq e lexues në tërë hapësirën shqiptare e matanë, nga skena në Vlorë e Fier, Elbasan e në Tiranë, kudo në qytetet ku skena e priste dhe e pret gjithnjë fjalën tënde të rallë.

Ish shokët e kursit në degën mekanike të Politeknikut “7 Nëntori” ende tregojnë atë djalosh që me seriozitetin dhe fjalën e tij kishte lënë shenjat e para të talentit që i kishte dhënë Zoti, talent të cilin do ta plotësonte me studimet e larta në Shkollën e Lartë Teatrale “Aleksandër Moisiu”. Më pas regjisori i Estradës së Vlorës, vetëm një vit më pas do t'i bashkohej trupës së aktorëve të Teatrit të atij qyteti, por nuk do të lihej rehat pasi më 1967 bie viktimë e luftës së klasave dhe biografia me njollë e çon për riedukim në gurorë, minierë e më pas në oficinë. “Riedukimi” do ti zgjaste po aq sa iu desh për të kryer studimet e larta, plot katër vjet. Më tej tetëmbëdhjetë vitet si aktor në Teatrin e Fierit, regjisori i Estradës dhe Teatrit, do të tregonin se “kulla” tashmë ishte jo vetëm talenti, por edhe suksesi për këtë institucion kulturor. Ishte koha kur “kulla” tashmë kishte kthyer çmimet më të larta në festivalet kombëtare për Teatrin dhe Estradën e Fierit. Firmos libretin dhe regjinë në pesëmbëdhjetë spektakle, ndër të cilët

“Çobo Rrapushi me shokë” u bë një sukses kombëtar afatgjatë, sikurse kishte ndodhur dhe lme ibretin dhe regjinë në pesëmbëdhjetë spektakle. Shkrimi i më se 300 skeçeve dhe komedive

një aktëshe, 40 kupletete dhe 23 monologjeve, shumica e të cilëve u shfaqën në TV e tregoi jo thjesht se “kulla” tashmë kishte ngritur lart vlerat, por se ishte koha e artit e tij që pasohej nga botimet voluminoze nga Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” nën titujt që u bënë mjaft popullore dhe të dashur për shqiptarët. E kush nuk e mban mend dhe ende shkul të qeshurën me “Lipe Shtogu në listë”, “Shoku Niqifor”, “Portrete pa makiazh”, “Po martojmë Malon” ‘Këshilla për fëmijët e moshave nga 5 deri 55 vjeç, si edhe ato që botoheshin në buletin “Teatër”. Më të plotë letërsinë e tij për skenën e gjejmë në pesë vëllime, në një botim të bukur financuar nga Bashkia e qytetit të Fierit, me titullin e përbashkët “Teatri kjo lojë magjepsëse”. Dhe “kulla” nuk duhet të ndjehet vetëm për ditëlindje...

Nga 1977 deri më 1990 ishte bashkëpunëtor i përhershëm i TVSH për spektaklin e Vitit të Ri. Më 1987 i jepet Çmimi “Naim Frashëri” i Klasit të Dytë. Paralelisht me punën në Estradë, realizon dhjetë produksione dramatike, të gjitha drama ose komedi të shkruara prej tij, nga të cilat shquhen “Shoku Niqifor”, “Dy krismat në Paris”, “E bukur kristi e vjetër”. Produksionet shfaqen me sukses në të gjithë vendin, si edhe në festivalet kombëtare, por nuk arrijnë kurrë më lart se çmimi i dytë. Përshtatimin e bën komedia “Sa shumë gjethe të thata atë vjeshtë”, vënë në skenë nga regjisori me emër dhe mjaft i talentuar, Siro Duni në Teatrin “Skampa” të Elbasanit, që fitoi çmimin e parë në Festivalin Kombëtar të vitit 1989.

Më 1990 largohet nga Fieri, për të nisur punën si pedagog, e më pas Dekan i Fakultetit të Artit Skenik, në Tiranë. Karriera

e tij pedagogjike nuk zgjat shumë, pasi zëvendësohet nga ajo diplomatike. Më 1992 emërohet Sekretar për Kulturën dhe Shtypin në Ambasadën e Shqipërisë në Bonn, Gjermani dhe një vit më pas Ambasador në Misionin Shqiptar pranë OKB, në Nju Jork (1993-1997). Pas përfundimit të shërbimit diplomatik shtetëror doli në pension dhe u vendos me familjen më parë në Waterbury, Connecticut. Shumë shpejt u rikthye në Neë York dhe u angazhua për afro dy vjet si gazetar dhe editing manager i gazetës shqiptaro-amerikane “Illyria”. Gjatë qëndrimit në SHBA prodhimtaria e tij u pa e begatë. Botoi një seri librash që u pritën me interes. E nisi fillin me esenë e gjatë me një studim të gjithanshëm të humorit nën diktaturë, “Si qeshnim nën diktaturë” dhe vijoi me romanet “Rrëfenja nga Amerika”, “Lejlekët nuk vijnë më” dhe “Vdekja e Enver Hoxhës”. Ndërkohë Shtëpia Botuese TOENA e përfshiu autorin në kolanën e Tregimeve të Zgjedhura të Autorëve Shqiptarë me vëllimin me tregime “Pushtimi i Amerikës” (2005) teksa Shtëpia tjetër Botuese GEER ia përmbloodhi edhe një herë më gjerë novelat dhe tregimet e tij nën titullin atraktiv “Rrëmbimi i nuses në Nju Jork” (2012). Pa u shkëputur nga librat e tij shënojmë një botim të bukur të Universitetit European të Tiranës me afro 700 faqe nën titullin emblemik “Luftë pa Fund” ku gjenden tërë shprehuritë politike të autorit në periudhën e tranzicionit të zgjatur të vendit të tij.

MESAZHI I AMBASADORES SË SHBA: SHËRBYES PUBLIKË, BËNI PUNËT TUAJA ME BESNIKËRI NDAJ SHTETIT LIGJOR

Ambasadorja amerikane në Shqipëri, Yuri Kim, ka vënë theksin në rëndësinë e zbatimit të Reformës në Drejtësi, por ka përcjellë edhe një mesazh të qartë për “shërbyesit publikë”.

Në takimin e organizuar nga ministrja e Drejtësisë, pasditen e djeshme, ambasadorja Kim tha “për të gjithë ne sonte, qofshim amerikanë, gjermanë, shqiptarë, italianë, tha znj. Kim, pjesa më e madhe prej nesh, të gjithë ne në fakt, jemi qytetarë publikë, shërbyes publikë. Dhe jemi mbledhur këtu për të shënuar kauzën e nderuar “Drejtësi për të Gjithë” dhe po punojmë për të siguruar begatinë ekonomike dhe demokratike

të Shqipërisë”.

“Ne mbartim një privilegj të madh dhe një detyrë edhe më të madhe për të siguruar besimin e publikut se do t'i bëjmë punët tona me integritet, me besnikëri ndaj shtetit ligjor dhe parimeve të paanësisë. Prandaj na quajnë shërbyes publikë...”

Në çaste kritike, Shtetet e Bashkuara kanë qenë gjithnjë pranë miqve dhe aleatëve shqiptarë... Ky çast, ndërsa ju përpiqeni të zbatoni plotësisht reformën në drejtësi, është një prej tyre. Dhe ashtu siç e kam thënë më parë, për të gjitha çastet e kaluara, ashtu dua t'ju them sërish sonte, se në reformën në drejtësi, jemi me

ju krah për krah”, u shpreh ajo.



BIG BOSS SERVICES

(UK) LTD

BUILDING CONTRACTORS

[big_boss_services_uk_ltd](#)
 [@BigBossServices](#)
 [BigBossServicesUKLtd](#)

OUR SERVICES INCLUDE:

Guttering	PVC Windows	Plastering
Painting	Loft Conversion	Carpentry
Decorating	Extensions	Roofing
Power Clean	Kitchen Fitting	Brickwork
Scaffolding	Bathroom Fitting	Tiling



Tel: 020 8591 9198

Mobile: 07747 143 704 / 07883 029 474

Email: bigboss.services@yahoo.co.uk

website: www.bigboss-service.webs.com

UTR: 7168616298

CRN: 8344897

VAT NR: 215642524

Shesim apartamente në Durrës, Tiranë dhe ne zonën e plazhit deri tek Mali i Robit

Kontakt: 07883029474 dhe 00355685309800

NJË VËSHTRIM MBI LIBRIN “ROMA FLISTE SHQIP” TË STUDJUESIT FAHRI XHARRA

Nga Zihni Elezi


Një vështrim mbi librin “Roma fliste shqip” të studjuesit Fahri Xharra. Duke përfunduar pjesën e parë “Pellazgët dhe origjina e tyre”, duket menjëherë se autori ka bërë një punë të admirueshme. Ajo që më bën pershtypje tek autori i librit “Roma fliste shqip”, Fahri Xharra është se vërtetë historia shkruhet dhe rishkruhet nga këndvështrime të ndryshme por kronikat në rrëfimin e historisë janë një thes bosh nëqofese nuk kanë faktin brenda. Edhe gjatë leximit të recensionit të librit “Roma fliste shqip” dhe më shumë se vepra e Fahriut që, pershtypje më bën dëshira e recenzentit për të promovuar dhe paqyruar origjinën e shqiptarëve e cila herët a vonë do ta lerë pas si panhelenizmin ashtu dhe pansllavizmin. Këtë e konfirmojnë edhe shume dokumente sekrete të Raihut të Tretë, që besoj se do të bëhen publike. Nuk ka një përgjigje adekuate se ç’janë pellazgët pasi burimet arkeologjike që disponohen dhe mundësitë janë tepër të kufizuara por ajo që mund të thuhet është në faktin se përderi sa ka një substrakt paleobalkanik i cili është indoeuropian si në pikpamjen

kulturore ashtu edhe në atë etniko-gjuhësore është pikërisht kjo optike që lejon për të parë lidhjet që egzistojnë midis ilirëve të epokës së hekurit dhe këtij substrakti të lashtë. Une kam informacion për historinë e Romës por pasi burimet janë asimetrike dhe shpresoj shume se përderisa këtë libër e kanë marrë përsipër edhe autorët, artikujt e të cilëve janë vendosur në pjesën e parë të librit, patjetër që Fahri Xharra do të ketë vërtetë një qasje interesante. Fahri Xharra ka meritën sepse historinë e popullit të tij nuk e shkëput nga historitë e popujve të tjerë dhe të tërë njerëzimit, por e studjon veçmas dhe njëkohësisht paralel me zhvillimet e historisë jo vetëm të popujve fqinjë. Kjo lidhet edhe me teoritë e lëvizjes relative së trupave në mekanikën teorike, ku studimi i një trupi që lëviz vetë dhe njëkohësisht ndaj një tjetri, bëhet me shkëputjen imagjinare të dy lëvizjeve., e më pas bashkohen të dyja. Njohja e histories të popujve të tjerë veçanarisht të atyre popujve që na rrethojnë si dhe njohja e historisë kombëtare na bën të aftë të orientohejmë drejt në situata konkrete aktuale shoqërore, ekonomike, brenda dhe jashtë vendit. Në këtë mënyrë duke njohur mire

historinë jemi jo vetëm me identitet dhe krenari për veten por krijojmë respekt dhe për popujt e tjerë. Me të drejtë studjuesi Fatmir Minguli, në recensionin e këtij libri thekson se: “Fahri Xharra krejt i përqëndruar në kontinentin italian, është i sinqertë dhe shumë korrekt, duke mos u përhapur nëpër tokat greke dhe as në toka të tjera që me akliminë e kohës u sllavizuan. Eshte një veçori e studjuesit të saktë.” Ka dhe një tjetër veçori që duhet parë, ajo e tendencës për t’i ndarë nga qytetërimet, por kjo tezë ka rënë dhe rezultatet e nxjerra nga studjues të huaj dhe vendas, jo vetëm duhet të njihen por edhe të pranohen. Ajo që Fahri Xharra përpiket të sqarojë është fakti se ç’nivel ka patur qytetërimi pellazg, para lirir, në ç’raport me qytetërimet e tjera të kësaj periudhe siç janë qytetërimet e Egjeut, të Anatollisë, dhe Italisë së Jugut. Të gjitha perënditë janë pellazge megjithatë pasardhës të qytetërimit pellazg nuk jemi vetëm ne, pasi qytetërimet janë të gërshtuara dhe autori mundohet mos t’i veçojë nga njeri tjetri. Ai ka ditur të ndërthurë elementët e qytetërimeve, ku ndonëse duket që dominanca është greke, ka diferenca dhe influence të Italisë së Jugut. Vërtetëbota greke i dha qytetërim gjithë globit dhe kultura greke ka vendin që meriton, por ajo që autori kërkon të theksojë është se ilirët nuk ishin barbarë dhe



civilizimi Helen, atë që jo vetëm e përqafoi por edhe e realizuan dhe jetësuan në qytetet e tyre. Veçori tjetër që bie në sy në pjesën e parë është fakti se për pellazgët dhe pellazgjishten dhe për lidhjen me popujt e tjerë është marrë opinioni shkencor i cili është pranuar nga të gjithë. Në pjesën e dytë patjetër që do bëhen komentet e tjera. Ky libër me rëndësi të jashtëzakonshme kulturore për shqiptarët pasi për mendimin tim me aq njohuri sa kam dhe sa kam lexuar, është nga veprat më të mira dhe interesante që gjurmon historinë dhe origjinën e shqiptarëve qysh në kapërcyell të agimeve njerëzore. Por libri “Roma fliste shqip” i autorit Fahri Xharra merr një rëndësi veçanarisht për brezat, pasi i njeh ata me prejardhjen e tyre dhe me lëvizjet e tyre politike shoqërore në shekuj. Gjithashtu ky libër implementon aftësi njohëse të cilat janë tepër të domosdoshme për studimin e historisë dhe të etapave që shqiptarët kanë kaluar në zhvillimin e tyre. Histori don të thotë të njohësh prejardhjen tënde nga lashtësia deri sot. Nëpërmjet studimit të tij duke mbledhur lloje të ndryshme faktesh dhe duke i sistemuar ato, ka krijuar tablo brilante për origjinën e shqiptarëve. Të dhënat që ai na jep qofshin të drejta apo dhe të tërthorta, janë tepër bindëse dhe të dobishme.



PSE EVROPA KA NDRYSHUAR?

Dhuna, djegiet e makinave dhe shpërthimet nuk duhet të bëhen normativa e re.

Shtypi shqiptar, i fiksuar pas sëmundjeve të brendshme të politikës shqiptare, mbetet i heshtur për problemet e shumta që ndodhin në pjesën tjetër të Evropës, ku shqiptarët ende vazhdojnë të mësyjnë me të gjitha format, ku shqiptarët, jo ndryshe nga shumë të tjerë ende mundohen të mbajnë ëndërrat gjallë me "E duam Shqipërinë si gjithë Europa!". Një shembull i tillë është se si, vitet e fundit, festa e Vitit të Ri në kontinent është shndërruar ngadalë nga një mbrëmje e festimit të natyrës së mirë në diçka që ngjason më ngushtë me dikë a diçka që të shpëtoj nga një cilësi, gjendje ose ndjenjë e padëshiruar. Në disa qytete dhe qytete evropiane, 31 dhjetori u shënua nga djegia e makinave, sulmet ndaj punonjësve të urgjencës dhe policisë, shkatërrimet e kishave dhe të shtënat. Shembujt janë të shumtë. Sipas

mediave vendase dhe disa burimeve të tjera mediatike, në Strasburg, Francë, tek shtëpia e pushimit e Parlamentit të BE-së, më shumë se 220 makina u shkatërruan me zjarr e me mjete të tjera gjatë "festimeve" në ardhjen për këtë vit të ri. Kjo flet mes statistikave, se shënon dyfishin e numrit të makinave të djegura vitin e kaluar. Zjarrfikësit që morën pjesë në shuarjen e flakëve u sulmuan. Siapas pamjeve që vijnë të shfaqen jheraherës online, shihet se kishte skena të ngjashme të dhunshme në të gjithë Francën, përfshirë raportet që sillen dhe raportohen për disa që ecnin rrugëve me kallashnikovë në Marsejë.

Në Gjermani, një oficer policie në Leipzig duhej të bënte një operacion urgjent. Policët u sulmuan me mjete djegieje dhe fishekzjarre. Sindikata lokale e policisë tha se dhuna këtë vit kishte marrë një 'pamje të re'. Sulmi po trajtohet si vrasje në tentativë. Në të njëjtën natë në të njëjtin qytet, 25

panele xhami u shkatërruan me gurë. Dritaret i përkisnin Kishës 800-vjeçare St Thomas, vendi i varrosjes së JS Bach. Në Bruksel, u dogjën disa automjete dhe më shumë se 180 njerëz u arrestuan. Shpërthimet në Suedi nuk janë të kufizuara në fishekzjarret e Vitit të Ri, mbi 100 shpërthime u raportuan vitin e kaluar. Sigurisht, fishekzjarret kanë qenë prej kohësh pjesë e natës së Vitit të Ri dhe gjithmonë kanë sjellë rreziqe. Në Hollandë, një burrë dhe fëmija e tij u vranë kur fishekzjarret sollën zjarr në mjediset e komplekseve të banesave. Por ajo që është e re në këtë rrëmujë dhe indinjatë është përdorimi i fishekzjarreve si armë predhash për të djegur automjete dhe për të sulmuar oficerët e policisë.

Disa fajësojnë dhunën mes bandave rivale, ndërsa të tjerët fajësojnë alkoolin. Këto shpjegime kanë një kuptim të 'asgjë për të parë këtu' rreth tyre. Në fund të fundit, Evropa gjithmonë ka pasur alkool, dhe gjithmonë ka pasur banda,

por nuk ka përjetuar nivelin e indiferentizmit ndaj autoritetit, dhe përcimit për një popullsi më të gjerë, që këto "metoda" të reja duket se demonstrojnë. Sido që të thuhet për Europën e sotme, fakti është fakt. Çfarëdo që të fajësohet, duhet kuptuar qartë që diçka ka ndryshuar. Shumica e njerëzve e pranojnë se nuk ishte gjithmonë rasti që qytetet e tyre kishin nevojë për 'zona të sigurta' për gratë dhe të tjerët në prag të Vitit të Ri. Tregjet e Krishtlindjeve nuk kanë nevojë gjithmonë për barrikada dhe polici të armatosur. Mediat kryesore dhe politikanët duhet të bëjnë shumë më tepër për të kapur atë që po ndodh. Rreziku mbetet që të mos flasësh për këto çështje dhe të pretendosh se asgjë nuk po ndodh do të nxisë, sepse nxit ekstremizmin politik. Nëse rrjedhë kryesore për median dhe autoritetin e Fjalës së Lirë, është që të mos flasësh për atë që po ndodh në Evropë, atëherë të folurën do ta bëjnë aktorë të tjerë, ndoshta më të sinqertë?!



VITET 2020 DUHET TË JENË DEKADA E DYTË E NJERËZVE

Po ikën java e parë e vitit që sapo uruam mes njëri-tjetrit, dhe ende nuk e kuptojmë se ka shkuar aq shpejt dekada që nisi në 2010-ën. Kemi qenë aq të përhumur sa dhe një dekadë na është dukur sikur nuk ka ekzistuar, sikur nuk e kemi nisur të-pas-dymijtën me një risi ndryshe. Pra, vitet 2010 kanë marrë fund. Dhe çfarë dekade misterioze dhe intriguese ka qenë? Dekadat janë kategori të rralla politike. Gjashtëdhjetat, si një fenomen, nuk filluan me të vërtetë deri në vitin 1963 apo 64 për ne shqiptarët, pasi pritëm me të madhe, me duartrokkitje kongresore “Ndërtimin e Bazave të Socializmit”. Të tetëdhjetat keqkuptohen si një kohë që na kushtoi jo mjaft me arrëzat e tufëzat, me racionimet, me maskaradat dhe shpikjet racionale, ndërsa për Botën Perëndimore ishte një epokë e triumfalizmit të tregut të lirë, me pamje nga ai PC, relativizmi kulturor, faji pas kolonialist dhe fundi i Luftës së Ftohtë që kishte siguruar Perëndimi me një goditje të qëllimeve morale të gjitha u zhvilluan në atë dekadë të tronditur, duke i dhënë shkas viteve të vetë-dyshimit perëndimor, madje edhe të vetë-urrejtjes, në vend të kokëfortësisë konservative, që analfabetë historike e shohin si zhurmë politike në vazhdim të Tetëdhjetëve. Nëntëdhjetat na sollën britma dhe thirrje, shpresën e humbur dhe ikjet masive, anijet dhe shembjet e kufinjve.... Por, ende kanë dhimbje ... dhimbje që vazhdojnë me ikje masive. Me ikjen e të rrinjve. Por vitet 2010, kjo dekadë ndërsa në Botë ndjehet disi mirë, tek shqiptarët është ende një shëllirë. Ndihet sikur ka

një histori, një hark, të paktën në kontekstin shqiptar. Për këtë është dekada që fillon me Edi Ramën, duke fyer një media të tërë që e priti me gjysëmshkulli lirinë, si një “kazan” dhe përfundon me opozitën që revoltet kundër similitudeve diktatoriale të ish Punës për qindra mijëra prej tyre. Fillon me krizën e sotme politike, kur PD dhe opozita e detyruar ekspozoi

për sovranitetin kombëtar dhe vlerat e komunitetit. Nga njerëzit që qortojnë fuqitë, që janë dhe mbesin duke i detyruar ata, përmes kutisë së votimit, të respektojnë vullnetin e njerëzve dhe vetë njerëzit. Kjo ndoshta duhet të rifillojë me ngut nga 2020. Kjo ka qenë një dekadë plotësisht dramatike. Duhet të ishte Dekada e Popullit, në të vërtetë, në të cilën

dekadë. Një luftë, së pari, e elitave kundër një populli që ata e konsideronin të ngulitur, budalla dhe shumë të lidhur me vlerat kombëtare. Dhe pastaj një kundërsulm nga masat, që presin me Drejtësi, një ekzekutim të mençurisë së turmës kundër shkatërrimit të pushtetarëve tanë pa prekje. Një rivendosje e rëndësisë së demokracisë kombëtare, e solidaritetit të komunitetit



djegjen e mandateve, dhe ajo përfundon me masën lëvizëse të dështuar studentore. Nga të gjitha këto: nëse 2010-ta tregon dhe hyn në një histori, ajo është një revoltë e thellë, e pamenduar e politikës shqiptare. Nga njerëzit e zakonshëm që shtyhen për të ikur, prapa lakmive dhe punës e punërave në Gjermani apo gjetkë, tek struktura në pikëpyetje e edukimit dhe thelbi i sotëm debatues i Universitarizmit. Prej pjesëve të gjumit të gjatë dhe të ndërhyrjes dhe të riedukimit të publikut që duhet të ngrihet në pritje të ditëve për më të mirë të tyre dhe që të rivendosin çështjen

demokracia duhet të bënte, atë që demokracia ka për qëllim të bëjë: marshalllo hutimin e turmës për të realizuar dhe heshtur lëvizjet e duhura, elitare, demokratike të klasave qeverisëse. Por, Dekada e Popullit fillon me të vërtetë duhet të fillonte në vitin 2010. Ajo gjithësesi mbeti si zhurma mes Opozitës së detyruar dhe Pozitës arrogante. Zhurma gjuhësore midis këtyre dy skajeve politike, fliste dhe flet për vëllime rreth largimit të politikave nga baza e saj, nga vëmendja e masës së gjerë. Një luftë e pandalshme ka përhapur mospajtimet në politikën shqiptare, në këtë

dhe e traditave dhe vlerave që na ankorojnë dhe na forcojnë kundër varrosjes së jetës në shoqërinë e sotme të mirëkontrolluar klienteliste-kapitaliste. Përfundon Dekada e Popullit? Edi Rama është hakmarrë, pushteti i tij është mbrojtur dhe kultet e globalizmit dhe individualizimit janë shumë në prapavijë, duke ngritur zhurmën edhe në skajet diplomatike me zërin e të huajve. Diku ka lëvizje, diku ka heshtje, diku ka dhimbje nga dekada që lamë pas. E gjitha që mbetet tani është të sigurohemi që vitet 2020 janë Dekada e Dytë e Njerëzve.

NUTRICIONISTJA SHQIPTARE EGZONA MAKOLLI INICON “LYFERROOTS” NË LONDËR

Egzona Makolli, është shqiptarja që inicoi ditën e mërkurë, 15 janar 2020, ora 6:30 në BoysnBerry 839, Fulham të parën lidhje shkencore me nutricionizmin. Nutricionistja shqiptare tashmë është ligjërish një person që këshillon të tjerët për çështjet e ushqimit dhe të ushqyerit dhe ndikimet e tyre në shëndet. Në këtë fushë, disa njerëz specializohen në fusha të veçanta, të tilla si ushqimi sportiv, shëndeti publik ose ushqimi i kafshëve, midis disiplinave të tjera. Në shumë vende, një person mund të pretendojë të jetë një nutricionist edhe pa ndonjë trajnim, arsim, ose licencë profesionale, për dallim nga një dietolog, i cili ka një diplomë universitare, licencë profesionale dhe certifikim për praktikë profesionale, por Egzona i ka të gjitha. Egzona Makolli (BSc Hons. MSc ANutr) ka një diplomë Bachelor në Ushqyerjen e Njeriut dhe një diplomë Master në Ushqyerjen Klinike nga Universiteti i Roehampton. Egzona natyrshëm iu dedikua edhe doktoraturës së saj në Epigjenetikë dhe Sëmundjet e Crohn në Kolegjin Universitar në Londër duke bashkëpunuar me Universitetin e Oksfordit, por në këtë pikë tashmë ka më shumë vëmendjen e saj në këtë pikë të re. Dhe pika e re e saj është tashmë “LyfeRoots” (Rrënjët e jetës) për të cilat ajo na tha se janë pikërisht rrënjët e vendlindjes, Kosovës, aty ku ajo mësoi nga nëna dhe babai mjaft për dashurinë ndaj natyrën dhe lidhjen shqiptare. Egzona dëshmoi për herë të parë efektet e të ushqyerit në shëndetin e saj në moshën 16 vjeç, kur ajo u klasifikua si me mbipeshë dhe kishte shumë probleme të lidhura

me shëndetin. Kuptimi natyror i Egzona Makollit, se si ushqimi ndikon në shëndet dhe zhvillimin e sëmundjeve e bëri që ajo të regjistrohej për një diplomë universitare në Human Nutricion. Ajo tashmë këshillon klientët për një sërë problemesh shëndetësore dhe është e specializuar në Menaxhimin e Peshës, Shëndetin tretës, Shëndetin Kardiovaskular dhe Ushqimin e Sporteve. Qasja e saj e drejtpërdrejtë përfshin një analizë të thelluar me qëllimin për të gjetur, pikërisht, rrënjën e shkakut me qëllimin për të ndihmuar klientin të arrijë shëndetin optimal. Egzona e di se çdo klient është unik dhe se një plan nuk i përshtatet të gjithëve, ajo harton plane për çdo klient në varësi të nevojave dhe qëllimeve të tyre shëndetësore. Duke përdorur përvojën e saj dhe të kuptuarit e të ushqyerit, Egzona ndihmon në inkurajimin e klientëve të saj të bëjnë ndryshime premtuese në jetën e tyre të përditshme pa kufizuar grupet ushqimore ose duke përdorur dieta të zbehta. Egzona është anëtare e Shoqatës së Ushqyerit dhe është e regjistruar si një “Nutricion i Asociuar” (ANutr). Ajo gjithashtu mban një anëtarësi në shoqërinë ushqyese dhe rregullisht merr pjesë në seminare të akredituara me bazë shkencore nga CPD. Ajo është gjithashtu një studiuese e shkencës që beson se këshilla duhet të jetë e bazuar në prova dhe rregullisht merr pjesë



në simpoziume shkencore. Nutrizmi është shkenca që interpreton ushqyesit dhe substancat e tjera në ushqim në lidhje me mirëmbajtjen, rritjen, riprodhimin, shëndetin dhe sëmundjen e një organizmi. Ai përfshin marrjen e ushqimit, thithjen, asimilimin, biosintezën, katabolizmin dhe sekretimin. “Nutrition” (procesi i sigurimit ose marrjes së ushqimit të nevojshëm për shëndetin dhe rritjen) tashmë është në vendimmarrjen e Egzonës e cila të gjithë planet e saj i mbështet tek baza natyrale. Të gjithë duam të arrijmë shëndetin më të mirë që mundemi dhe në “LyfeRoots” qëllimi ynë është ndihma që ju të arrini shëndetin më të mirë të mundshëm përmes përdorimit të shtesave ushqimore me cilësi më të lartë me përbërës të bazuar në bimë për shëndetin optimal. Egzona na thotë se “Ne jemi te specializuar në sigurimin e formave më bio të disponueshme të vitaminave dhe mineraleve përmes shtesave ushqimore të formuluar nga një specialist i industrisë udhëheqëse

ushqyese. Ne sigurojmë që të mbështesim ushqimin tuaj për trupin mendor përmes përbërësve tanë të bazuar në bimë për të siguruar që të ndjeheni më së miri çdo ditë.” Në fakt duhet thënë hapur se “LyfeRoots” filloi kur nutricionistja e industrisë Egzona Mak (BSc Hons. MSc) vendosi që të tre kategoritë kryesore për shëndetin ishin Truri, Trupi dhe Nutrifikimi. Kjo u bazua në udhëtimin dhe përvojën e saj. Ishte pas gjysmë deкаде pune në industri dhe një ditë mbajtja e një takimi në ndryshim të jetës me një person themelor në industrinë e shëndetit dhe mirëqenies lindi “LyfeRoots”. Qëllimi i “LyfeRoots” është të kthehemi në rrënjët tona dhe të përdorim Nënë Natyrë përmes asaj që përcakton shëndetin: Mendja, Trupi dhe Ushqyerja. Dhe teksa në këtë promovim të ftuarit mbesin në interesimin e produktit pesë llojesh, prindërit e të afërmit e saj, koleget dhe kolegët ndjehen krenarë. Krenarë ndihemi të gjithë se kjo nismë është tashmë nga një shkencëtare e aftë shqiptare.

DAILY FRESH HALAL MEAT AND FRUIT



HILAL FOOD CENTRE

International Food Centre

318-324 Kilburn High Road,
London, NW6 2QN
020 7372 1059

VEAL
SPECIAL
OFFER

